



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 DHJETOR 2024**

**SA SVEÇANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 20. DECEMBRA 2024. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2024**

Rendi i ditës

1. Seanca e përbashkët ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Dnevni red

1. Zajednička sednica između Skupštine Republike Kosovo i Skupštine Republike Albanije

Mbledhjen e bahskëdrejtuan kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, z. Glauk Konjufca dhe znj. Elisa Spiropali.

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
E nderuar presidente e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu,
E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Elisa Spiropali,
I nderuar kryeministër i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama,
I nderuari kryeministër i Republikës së Kosovës, Albin Kurti,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabineteve tona qeveritare,
Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të dashur mysafirë,
Mirë se erdhët në këtë seancë që unë do ta quaja “historike”, sepse është seanca e parë që po ndodh në Republikën e Kosovës, që po ndodh në Prishtinë, pikërisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës si bashkim ndërmjet Kuvendit të Republikës sonë dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Unë ju lus që të ngrihemi në këmbë për himnin shtetëror të Republikës së Kosovës dhe për himnin kombëtar shqiptar.

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Seancë e përbashkët e kuvendeve tona, kam kënaqësinë t’ia jap fjalën shkëlqesive së tij, mikut tonë Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: E nderuar presidente e Republikës sonë, Vjosa Osmani-Sadriu,
E nderuar kryetare Spiropali,
Të nderuar kryeministra Rama e Kurti,
Të nderuar deputetë, kolegë të nderuar të kuvendeve tona,
Ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë,
Të nderuar ambasadorë të dy vendeve tona,
Miq të dashur,
Të dashur qytetarë,

Jemi mbledhur në këtë seancë të përbashkët të kuvendeve tona të Kosovës dhe të Shqipërisë në fund të këtij viti, për ta dëshmuar unitetin tonë përballë sfidave politike e atyre gjeopolitike, të sigurisë që e shoqërojnë rajonin dhe kontinentin tonë edhe gjatë këtij viti. Edhe dy muaj bëhen tre vjet që nga agresioni i paprovokuar i Federatës Ruse

mbi Ukrainën dhe mbi popullin e Ukrainës. Dhe ne si rajon, edhe si Kosovë i kemi ndier ndikimet e tërthorta e të drejtpërdrejta të këtij agresioni.

Republika e Kosovës po e mbyllë edhe këtë vit e sulmuar drejtpërdrejt nga elemente të cilat lidhen me Serbinë, e që po e synojnë destabilizimin e brendshëm të Kosovës me metoda terroriste, si dhe ato të luftës hibride. Sulmi që u bë para pak ditësh ndaj kanalit të ujësjellësit të Ibër-Lepencit nuk mund të konsiderohet ndryshe përveç se si sulm terrorist nga ata që refuzojnë ta pranojnë Kosovën si një realitet sovran dhe si një rend ligjor e demokratik, i cili nuk ka alternativë në tërë territorin e Republikës sonë. Të mos harrojmë që ky sulm i rëndë ndaj infrastrukturës sonë kritike të furnizimit me ujë dhe me energji, vjen një vit pas sulmit tjetër të rëndë që e përjetoi Republika jonë e që ishte sulmi në Banjaskë. Organizatori dhe mbështetës i këtij sulmi është Radoiçiqi dhe ky i mbështetur drejtpërdrejt nga presidenti Vuçiq, i cili ende mbetet i pandëshkuar nga drejtësia në Serbi, e cila pothuajse nuk ekziston fare.

Prandaj, ky përbashkim yni sot në këtë seancë të dy kuvendeve tona përbën më shumë se simbolikën e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona. Kjo seancë duhet me u pa si dëshmi që Kosova dhe Shqipëria janë me njëra-tjetrën, në çdo rrethanë dhe pa asnjë kusht, duke qenë se ne nuk mund të përfaqësojmë tjetër gjë, përveçse interesin kombëtar të kombit, i cili për ne është i përbashkët.

Kam pasur nderin ta drejtoj këtë institucion për një mandat të plotë të kësaj legjislature, të cilën po e mbyllim. Po ashtu, edhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë është pothuajse në fund të mandatit, duke qenë se zgjedhjet parlamentare janë caktuar edhe atje. Por, mund të them se si kuvende kemi pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm dhe e kemi ngritur në një nivel të ri bashkëpunimin tonë ndërparlamentar. E ky bashkëpunim është jo vetëm i krerëve, por është bashkëpunim konkret në fushën e ligjvënies, përmes deputetëve tanë dhe komisioneve parlamentare, të cilat takohen në baza të rregullta dhe kjo për ne ka qenë një arritje e konsiderueshme.

Përveçse përfaqësojmë të njëjtin komb, po ashtu përfaqësojmë edhe idealin e përbashkët të integritit evropian të shteteve tona, pra synojmë të njëjtën familje. Shqipëria ka ecur përpara në rrugën e integritit dhe mësimet e saj do të jenë shumë të dobishme për ne, pavarësisht rrethanave aktuale absurde të masave të cilat na i ka vendosur Bashkimi Evropian.

Në këtë mandat, Kuvendi i Kosovës ka zbatuar një agjendë të ngjeshur legjislative në mbështetje të programit reformativ të Qeverisë dhe si asnjëherë më parë ka dëshmuar stabilitet në kryerjen edhe të funksioneve të veta bazike. Si institucioni më i rëndësishëm i Republikës, kjo pa dyshim ka reflektuar edhe në klimën politike në mbarë shoqërinë

tonë. Kosova mbetet një kampion i demokracisë në rajon, e vlerësuar edhe prej institucioneve perëndimore dhe me këtë duhet të krenohemi të gjithë ne si popull. Shqiptarët gjithmonë kanë qenë aleati më i natyrshëm i vlerave perëndimore në Ballkan.

E falënderojmë Republikën e Shqipërisë, e falënderojmë Kuvendin, e falënderojmë Qeverinë shqiptare që ka qenë e zëshme për mbrojtjen e interesave të Kosovës, për mbrojtjen e shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare, në çdo forum të rëndësishëm të botës. E drejta e Kosovës për mbrojtjen e sovranitetit dhe të integritetit të saj, të forcimit të ligjit e të shtetit demokratik nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë cenim i fqinjësisë së mirë dhe as përshkallëzim i raporteve me fqinjët tanë. Është Serbia ajo që nuk na e pranon madje as statusin e fqinjit, por ambiciet e saj hegjemoniste kundër Kosovës vazhdon t'i ketë madje edhe të kodifikuara në Kushtetutën e saj. Nuk mund të ketë normalizim të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, pa pasur njohje reciproke si dy subjekte sovrane që nuk e kontestojnë njëra-tjetrën. Ne themi vetëm kjo është zgjidhja për relacionin mes Kosovës dhe Serbisë dhe ne jemi shumë të bindur që kjo do të ndodhë, sepse e kemi në krah Republikën e Shqipërisë.

Në fund, dëshiroj që t'i uroj qytetarët e dy shteteve tona për festat e fundvitit, me shpresë që viti që po vjen do të jetë vit i fuqizimit dhe i përparimit të mëtejshëm të kombit tonë. Për katër vjet është bërë shumë progres, edhe në Republikën e Shqipërisë edhe në Republikën e Kosovës. Uroj që në fund të mandatit të legjislaturës së ardhshme të kuvendeve tona do të jemi duke e festuar edhe pranimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si dhe pranimin e Kosovës në OKB dhe në organizatat e rëndësishme ndërkombëtare, duke e shënuar kështu finalizimin e sovranizimit ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës.

Ju faleminderit!

Tash, kam kënaqësinë që ta ftoj për një fjalë rasti kryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonjën Elisa Spiropali. Urdhëroni!

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Të dashur qytetarë të Kosovës e të Shqipërisë,
E nderuar Presidente e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu
I nderuar kryetar Konjufca, i dashur Glauk,
Të nderuar kryeministra të Republikës së Kosovës e të Shqipërisë, z. Kurti e z. Rama,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendit të Shqipërisë,
Unë me origjinë jam nga Bregu i Labërisë së Shqipërisë, kam lindur në Tiranë, por me shtëpi zemre jam nga Prishtina e Prizreni. E po kështu, secili nga ne është njëkohësisht nga Durrësi e Gjakova, nga Drenica e Shkodra, nga Korça e Peja. Sepse, jemi një gjak e një gjuhë, një histori e një kulturë.

Emocion i thellë dhe kënaqësi e pafund sot në këtë mbledhje të përbashkët mes dy Kuvendeve tona. Por, ka një problem, ne që po takohemi jemi pak, duhet të ishim më tepër. Duhet të ishim me mijëra, me qindra-mijëra e prapë pak janë. Duhet të takohemi të gjithë, aq sa jemi, aq sa shqiptarë ka bota, me miliona. Aq shqiptarë sa ka bota, nuk prishin punë, përkundrazi, nuk prish punë se s'na nxë kjo sallë, ka salla të tjera që na nxënë, janë fushat, pllajat e luginat, ku mund të takohemi e të çmallemi e të mirëkuptohemi me njëri-tjetrin. Përmetari ta takojë e ta përqafojë prishtinasin, gjakovari labin e pejanin, mitrovicasi vlonjatin e kështu me radhë. Derisa toka të dridhet nën këmbët tona, derisa Zoti të habitet, derisa Adem Jashari të lëvizë në varr, derisa bota ta mësojë cilët jemi e çfarë mund të bëjmë kur jemi bashkë.

Halli është se për të arritur deri te supertakimi, për të realizuar hiperbashkimin, duket herët, duhet pritur. “Kur s’ke pulën, duhet ngrënë shpend tjetër”, thotë populli, por doni ju që edhe ky shpend qenka fort i shijshëm sot në këtë takim.

Jo rrallë Ballkani ka qenë truall i ankesës dhe popujt e Ballkanit e kanë traditë të hershme që t’i projektojnë dramat dhe pakënaqësitë diku gjetkë, si për të gjetur ngushëllim për bregat që historia ka prodhuar pa fund në këtë pjesë të Evropës.

Ne shqiptarët nuk bëjmë dallim, por askush nuk mund ta mohojë se në këtë moment historik ku kemi mbërritur si kurrë ndonjëherë më parë shqiptarët kanë dëshmuar vendosmëri të palëkundur në rrugëtimin e tyre për shndërrimin e shoqërisë së vet në një shoqëri moderne evropiane në thelb dhe në sjellje, euroatlantike në orientim dhe të drejtë në çdo aspekt. Një çerek shekulli, jo më tepër, vetëm një brez njerëzore që në jetën e një kombi zgjat sa një çast në histori ka mjaftuar të dëshmojmë se çfarë energjie të pashtershme transformuese, progresi e force sjell liria.

Në liri kemi bërë tashmë zgjedhjen e duhur, që është edhe zgjedhja e vetme për dy pjesët e ndara të një kombi.

Sot në këtë takim të përbashkët, ne po ngremë në një nivel tjetër detyrimin tonë ndaj qytetarëve tanë për të vijuar me durim e vizion atë që etërit tanë e kanë bërë me gjak e sakrificë të skajshme.

Faleminderit edhe një herë që jemi bashkë!

Faleminderit, vëlla Glauk!

Faleminderit dy kryeministrave shqiptarë që janë të pranishëm!

Faleminderit çdo zemre shqiptare që pret e uron vijimin e traditës sonë për të diskutuara së bashku mbi projeksionet e së ardhmes për të parë ku jemi e çfarë kemi bërë mirë dhe

për të diskutuar se çfarë duhet të bëjmë më mirë nesër në agjendën tonë të përbashkët me frymëzim evropian.

Sot, në vazhdim të udhëtimit tonë të mundimshëm për të plotësuar amanetin historik të vlonjatit Ismail dhe frashërllit prizrenas, ne shkëmbejmë ide e pasione të përbashkëta, ëndrra dhe mallra, vizione dhe shpresa, si dhe bashkërendojmë plane e strategji të mirëkuptuara në rrugëtimin e pandalshëm drejt Evropës.

Realizimi i objektivit tonë strategjik, anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian, integrimi euroatlantik i Kosovës dhe njohja përfundimtare e saj si realitet i pakthyesëm gjeopolitik, rritja e rolit dhe peshës së faktorit shqiptar në rajon si një mekanizëm i pazëvendësuesëm stabiliteti, për paqen dhe sigurinë, janë detyrat tona, janë themeli i të ardhmes tonë.

Ndodh që historia të rrjedhë më shpejt sesa perceptohet e të shkruhet. Orientimi i gabuar për shkak të zigzageve të historisë nuk është opsion për ne, ndaj duhet të kuptojmë mirë historinë e re që po shkruhet në rajonin tonë dhe në botën që po ndryshon me shpejtësi.

Pikërisht orientimit tonë të qartë dhe të saktë në rrjedhat e reja, shpresoj se i përgjigjet ky takim i sotëm, ky stacion i ndërmjetëm kodifikimi qëndrimesh, që dikton energji të reja në strategjinë e përbashkët për afrimin dhe modernizimin e shoqërive tona. Marrëveshja mes dy Kuvendeve, e nënshkruar në shtator 2022, ka institucionalizuar bashkëpunimin tonë dhe u ka dhënë mbështetje e shtytje bashkëpunimit mes qeverive e institucioneve dhe afrimit të njerëzve tanë në të dy anët e Morinës. Bashkëpunimi mes dy republikave shqiptare është reciprokisht strategjik.

Kosova është prioritet kombëtar i Shqipërisë, Shqipëria është prioritet kombëtar i Kosovës. Suksesi i njërës republikë, është kusht i parë dhe i domosdoshëm edhe për suksesin e republikës tjetër shqiptare. Ritmi i njërës kushtëzon dhe ritmin e tjetrës. Shqipëria ka mbërritur në dyert e Bashkimit Evropian pas një udhëtimi sfilites, shpesh të mbushur edhe me zhgënjime e prapakthime. Si vendi kandidat me shpejtësinë më të madhe integruese, Shqipëria është ai vend i rajonit që ka merituar më tepër se çdo vend tjetër anëtarësimin në familjen tonë të natyrshme evropiane. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian brenda kësaj dekade është objektivi ynë strategjik kombëtar, një qëllim ambicioz, i mundshëm, i realizueshëm, dhe plotësisht i merituar në bazë të arritjeve tona si një meritë e njohur dhe jo një privilegj i dhuruar. Në harkun e dy muajve, Shqipëria hapi negociatat për grup-kapitullin e parë-Themeloret dhe negociatat për grup-kapitullin e gjashtë: Marrëdhëniet e jashtme dhe Politika e sigurisë dhe e mbrojtjes.

Shqipëria e ka njëjtësuar prej vitesh politikën e saj të jashtme të sigurisë me Bashkimin Evropian. Të njëjtën gjë, që Republika e Kosovës e ka të shkruar në Kushtetutë. Ne besojmë se vetëm partneriteti i plotë e reciprok, përtej debateve e kundërshtive për ngjarjet e ditës, është i vetmi mjet i arsyeshëm i Tiranës e Prishtinës për të përballuar sfidat e tyre në një mjedis gjeopolitik që shfaqet herë-herë edhe si armiqësor. Mjedisi ballkanik është një mjedis dinamik. Është detyra jonë të parashohim e të ndjekim me vëmendje ndryshimet dhe t'i japim përgjigjet tona më të mira të mundshme bashkë.

Motra dhe vëllezër,

Samiti Bashkimi Evropian-Ballkani Perëndimor rikonfirmoi mbështetjen për politikën e zgjerimit drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ne jemi të brengosur që Kosova nuk e ka fituar ende këtë status, që sipas një gjykimi të përgjithshëm, e ka merituar më herët. Ne nxisim pesë vendet e vetme të Bashkimit Evropian që nuk e kanë njohur ende, të pranojnë se çfarë mund të bëhet tani nuk është mirë të lihet për më vonë, se herët a vonë është e qartë se Kosova do të jetë edhe një flamur më shumë në selinë e OKB-së, edhe një yll më shumë në flamurin evropian.

Shqipëria ka mbështetur dhe do të vijojë të mbështesë pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Ne besojmë se Republika e Kosovës i ka plotësuar të gjitha kushtet për anëtarësim dhe pranimi i saj si anëtarja e 47-të e Këshillit të Evropës është vetëm çështje kohe dhe do të ndodhë shpejt.

Delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës do të vijojë të jetë promotori dhe mbështetësi i fortë i këtij procesi. Sfidat specifike që ka Kosova janë të kuptueshme dhe ato janë njëherazi edhe sfidat tona që burojnë nga e drejta e natyrshme dhe Kushtetuta jonë. Në këtë kontekst, dialogu Kosovë-Serbi, në koordinim të plotë me partnerët tanë të përbashkët strategjikë, SHBA e BE, duhet të kenë medoemos, si rezultat përfundimtar, nënshkrimin e një marrëveshjeje të detyrueshme ligjore, që mundëson njohjen e ndërsjellë mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtim të drejtë të minoriteteve, konform Kushtetutës së Kosovës.

Pa njohje të ndërsjellë dhe përfundimtare, pa dalje me guxim nga labirintet artificiale që krijohen nga interesat e ditës, e ndoshta edhe të votës, ky skaj i Evropës do të jetë gjithmonë një dhembje koke për banorët e tij.

Ne kemi bindjen e palëkundur se Kosova do ta përmbyllë këtë proces si një shtet me vizion euroatlantik, si një partner strategjik serioz i vlerësuar dhe i dinjitetshëm përballë aleatëve tanë.

Me mbështetjen e partnerëve tanë strategjikë euroatlantikë, çdo objektiv i Shqipërisë, Kosovës dhe shqiptarëve kudo ku janë, lehtësohet. Është koha e shqiptarëve të punojnë për shqiptarët, sa edhe shqiptarët vetë punojnë për kohën e tyre. Si anëtarë aktivë të NATO-s, ne nxisim forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të Kosovës me Aleancën. Delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të Aleancës do të jetë i fokusuar në këtë mision.

NATO është garancia e pazëvendësueshme e sigurisë së Kosovës dhe gjithë botës, ku ne përkasim. Ne ndjekim me shqetësim spiralen e destabilizimit që herë pas here ngre krye si gjarpër i posazgjuar në veriun e Kosovës.

Ne mbështesim përpjekjet shumëplanëshe të Qeverisë së Kosovës, të shtetit të Kosovës, e të gjitha forcave në Kosovë dhe të gjitha autoriteteve ligjzbatuese për garantimin e ligjit në çdo hapësirë të Republikës së Kosovës në partneritet të ngushtë me partnerët tanë.

Shqipëria e konsideron si akte dramatike dhe i dënon si dalldira të së shkuarës frymëzimet nacionaliste që kërkojnë ta mbajnë veriun e Kosovës peng të maktheve që vijnë nga errësira e shekujve.

Shqipëria dhe Kosova, si dy republika shqiptare në rajon, do të duhej të jenë të përqendruara në përpjekjen e tyre dhe të koordinuar për garantimin e të drejtave të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Mal të Zi, e në Luginën e Preshevës e kudo.

Ne ndjekim me vëmendje të thellë shqetësimet e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut për çështjen e gjuhës shqipe. Ne besojmë fort se askund tjetër më mirë se në Shkup nuk kuptohet më qartë ndjeshmëria e skajshme për gjithçka që lidhet me gjuhën dhe besojmë se gjithçka do të zgjidhet me frymën e ligjit, të Marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe respektit reciprok mes dy etnive më të mëdha shtetformuese të vendit fqinj e mik.

Ne mendojmë se të drejtat e fituara të shqiptarëve në vendet e rajonit janë të pakthyeshme dhe kusht i pazëvendësueshëm për ndërtimin e shoqërive demokratike në ato vende. Askush si shqiptarët nuk ka krenarinë legjitime për të besuar e projektuar edhe për nesër bindjen e shndërrimit të faktorit shqiptar në mekanizmin më të rëndësishëm të garantimit të paqes, sigurisë dhe zhvillimit në të gjithë rajonin.

Pavarësisht problematikave tona lokale, ne jemi kontributorë të pazëvendësueshëm të asaj që duhet bërë për transformimin dhe Evropën e Ballkanit si të pakthyeshme këtu në hapësirën tonë.

Motra dhe vëllezër,

Republika e Kosovës është rezultat i veprës së grave dhe burrave të Kosovës dhe rreshtimit të tyre me Aleancën më të madhe politiko-ushtarake të kohës, nën flamurin universal të së drejtës së kombeve për të jetuar në liri, në paqe, në dinjitet.

Republika e Kosovës është realiteti më i ri gjeopolitik në Evropë, e lindur nga sakrificat të panumërta për t'u bërë shtëpi e përbashkët e të gjithë qytetarëve të saj.

Të punojmë se bashku për t'u bërë sa më shpejt qytetarë evropianë në një Ballkan të pandarë të Bashkimit Evropian, duke mos harruar për asnjë çast se takimet me dhjetëra dhe qindra nëpër zyra dhe salla nuk janë keq, por më të mira janë takimet me mijëra nëpër fushat, pllajtat, luginat e Kosovës dhe Shqipërisë, ku të takohemi e të çmallemi e të bashkëpunojmë nën qiellin tonë të lirisë.

Ju faleminderit dhe për të gjithë: Gëzuar festat!

Kam kënaqësinë që të ftoj për një fjalë rasti Presidenten e Republikës së Kosovës, Shkëlqesinë e Saj, Vjosa Osmani-Sadriu.

PRESIDENTJA VJOSA OSMANI-SADRIU: Faleminderit, të nderuar kryetarë të kuvendeve, zoti Konjufca dhe zonja Spiropali,

Të nderuar Kryeministra, Kurti dhe Rama,

Të nderuar deputetë të dy kuvendeve,

Të nderuar qytetarë të Kosovës, Shqipërisë dhe shqiptarë nga kudo që na ndiqni sot,

Zonja dhe zotërinj,

Të dashur motra e vëllezër,

Është nder t'ju drejtohem në këtë sesion të përbashkët Parlamenteve tona, në një takim që pasqyron jo vetëm trashëgiminë tonë të përbashkët, por edhe vendosmërinë tonë të palëkundur për të krijuar një të ardhme të denjë, të mbështetur nga vizioni dhe synimet e popullit tonë, i cili ka treguar përherë një forcë të jashtëzakonshme dhe një angazhim të pakompromis për liri, drejtësi dhe mirëqenie.

Kjo seancë e përbashkët parlamentare duhet të shërbejë si një thirrje për veprim, një kujtesë se qëllimi ynë i përbashkët kërkon ambicie edhe më të mëdha dhe përpjekje edhe më të palodhshme. Ne po jetojmë në një kohë të trazuar, e cila kërkon bashkëpunim dhe qëllim. Për Kosovën dhe Shqipërinë kjo nuk është thjesht një zgjedhje, por një domosdoshmëri. Një Shqipëri më e fortë do të thotë një Kosovë edhe më e fortë, një Kosovë më e suksesshme e ngrit edhe më lart Shqipërinë. Historia nuk do të na gjykojë me dashamirësi nëse nuk arrijmë ta shfrytëzojmë këtë moment për të ndërtuar unitetin dhe harmoninë e domosdoshme.

Prosperiteti i Kosovës dhe Shqipërisë është detyrë që na përket të gjithëve, liderëve, institucioneve dhe gjithsecilit qytetar. Secili prej nesh duhet ta luajë rolin e tij në avancimin e vizionit të shteteve dhe të qytetarëve tanë brenda familjes së kombeve evropiane. Lidhja e thellë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë është e rrënjësor në histori në sakrifica të panumërta dhe në një vizion të përbashkët për të ardhmen. Kjo lidhje nuk është thjesht simbolike, është një themel i pathyeshëm mbi të cilin duhet të ndërtojmë bashkëpunim më të madh e koordinim më të shpeshtë. Shqipëria dhe Kosova nuk janë vetëm dy shtete të pavarura, por janë dy pjesë të pandashme të një kombi të madh, të bashkuar nga një histori e lavdishme dhe një e ardhme e ndritur e cila po ndërtohet dita-ditës.

Të dy parlamentet tona si tempuj të demokracisë kanë një rol vendimtar në forcimin e lidhjeve tona dypalëshe dhe në avancimin e interesave të qytetarëve tanë. Të njëjtën përgjegjësi e bartim secili e secila nga ne.

Të nderuar deputetë të të dy Kuvendeve, derisa na keni mbledhur sot të gjithëve këtu në një kohë kur Shqipëria po bën hapa vendimtarë në rrugën e saj evropiane, dua të shpreh urimet e mija të përzemërta për liderët e Shqipërisë, Parlamentin e Shqipërisë dhe të gjithë qytetarët e saj për sukseset e deritanishme në negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kjo arritje është krenari jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë. Ajo tregon se përmes vendosmërisë, punës e reformave shtetet tona dhe rajoni ynë mund të sigurojnë vendin e merituar në familjen evropiane. Edhe Kosova si përherë mbetet me përkushtim të palëkundur për integrimin në Bashkim Evropian dhe angazhimi ynë në këtë drejtim është i çdoditshëm. Aspirata jonë për tu anëtarësuar në Bashkim Evropian nuk është vetëm një qëllim politik, por pasqyrim i asaj se kush jemi dhe çfarë përfaqësojmë. Pra, pasqyrim i identitetit tonë dhe i vizionit tonë. Kombi ynë mbrojti portën e fundit të Evropës qindra vjet para se të themelohej Bashkimi Evropian.

Prandaj, vlerat mbi të cilat është ndërtuar BE-ja sot qëndrojnë edhe në vetë themelet e kombit tonë. Fatkeqësisht pengesat me të cilat Kosova përballlet në këtë rrugëtim janë tejet të mëdha. Padrejtësitë ndaj popullit të Kosovës sa vijnë e rriten. Për t'i tejkaluar këto pengesa suksesshëm, na duhet mbështetja e vazhdueshme e Shqipërisë. Bashkimi Evropian do të jetë më i sigurt, më i qëndrueshëm dhe më i plotë me shtetet tona si pjesë e tij. Anëtarësimi i Kosovës në NATO ndërkaq do t'u japë përfundimisht fund appetiteve hegjemoniste e destabilizuese të Serbisë ndaj Kosovës. Për të arritur këtë të ardhme të përbashkët është jetike që ne ta forcojmë vazhdimisht koordinimin, komunikimin e bashkërendimin ndërmjet dy shteteve tona. Në veçanti është me rëndësi unifikimi i politikës sonë të jashtme, si dhe bashkëpunimi ynë në mbrojtje të pavarësisë së arritur me aq shumë sakrifica të Republikës së Kosovës, si dhe sovranitetit të shtetit tonë, e po ashtu

bashkëpunimi i vazhdueshëm në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve, pavarësisht se ku jetojnë ata.

Shqiptarët në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc i kanë sytë kah ne. Atyre vazhdimisht u shkelen të drejtat në mënyrë flagrante, përderisa bota demokratike po i mbyll sytë para këtyre shkeljeve. Ne duhet ta ngremë zërin më shumë se sa kurrë më parë në mënyrë që të ndërpriten këto shkelje ndaj popullsisë shqiptare, të cilët jetojnë në këto treva. Ndërkaq, derisa po flasim dhe jemi bashkuar në këtë Kuvend, akoma ekzistojnë tendenca për të shkundur themelet mbi të cilat është ndërtuar Maqedonia e Veriut, pra për të destabilizuar edhe këtë vend, duke larguar të drejtat tashmë të fituara të shqiptarëve që jetojnë në këtë shtet si popull konstituiv i Maqedonisë së Veriut. Ne nuk duhet as të qëndrojmë të heshtur, e as t'i mbyllim sytë para këtyre tendencave të qarta.

Të nderuar kryetarë të kuvendeve,

Kryeministra,

Deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Për Kosovën, Shqipëria ka qenë gjithmonë më shumë se një shtet motër. Shqipëria ka qenë një aleate e palëkundur, duke na qëndruar pranë në çdo hap të rrugëtimit tonë që nga ditët e luftës e të çlirimit dhe në çdo hap të ndërtimit të shtetit tonë të lirë e sovran.

Edhe sot Shqipëria mbetet një shtyllë e fortë e mbështetjes sonë, për këtë popull i Kosovës do të jetë gjithnjë mirënjohës. Në këtë takim të përbashkët të dy Parlamenteve shpreh vlerësimin tim të thellë për të gjithë deputetët, puna e të cilëve është po ashtu jetike për prosperitetin e shteteve tona. Përkushtimi juaj për demokracinë, përparimin dhe mirëqenien e qytetarëve tanë është një dëshmi e unitetit dhe forcës së popullit tonë. Zëri i deputetëve të Shqipërisë, qoftë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ashtu edhe në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, por edhe në çdo vend tjetër është më shumë se sa i vlerësuar nga populli i Kosovës dhe u jemi përjetë mirënjohës. Suksesi i Kosovës dhe i Shqipërisë është nderim i të kaluarës sonë të dhimbshme, detyrim ndaj vetvetes dhe qytetarëve tanë dhe ndaj të ardhmes sonë të përbashkët evropiane.

Qytetarëve të Kosovës dhe Shqipërisë u shpreh urimet më të ngrohta në këtë fundvit duke uruar që viti i ardhshëm të sjellë edhe më shumë begati, shëndet e suksese. Le t'i afrojmë dy shtetet tona çdo ditë e më shumë e më afër synimit tonë për një të ardhme edhe më të ndritshme të bashkuar në strukturat euro-atlantike. Së bashku si dy shtete të pavarura dhe sovraane të bashkuar nga gjaku, gjuha, historia dhe vizioni do të vazhdojmë të ecim përpara krahë për krahë, siç kemi bërë gjithmonë. Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë. Zoti e bekoftë kombin shqiptar! Ju faleminderit!

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Faleminderit për fjalën tuaj, e nderuar Presidente.

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: Tash, më lejoni që ta ftojme për fjalën e tij kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, zotin Edi Rama.

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË, EDI RAMA: I nderuar Kuvend i bashkuar i Shqipërisë dhe Kosovës,

Teksa një vit po ikën dhe një tjetër vit i ri po vjen, kanë kaluar pak më shumë se dhjetë vjet qysh se pata nderin t'i adresohem kësaj salle nga kjo foltore, si kryeministër i sapozgjedhur i Shqipërisë. Dhjetë vjet janë shumë pak në jetën e një kombi, por janë shumë në jetën e një individi.

E gjithësesi, kjo dekadë ka qenë vendimtare, për ne, në anën tjetër të bjeshkëve, në Shqipëri. Dhjetë vjet të një kthese të madhe, me sakrificë e mundime të mëdha, ku nuk kanë munguar as dhimbjet e fatkeqësive natyrore, që nga përmbytjet e deri edhe një tërmet shkatërrimtar e një pandemi globale. Por kur përjetoj sot habinë e miqve dhe vizitorëve gjithnjë e më të shumtë të mrekulluar nga transformimi i Shqipërisë në këto vite, them me vete ia kanë vlejtur pa asnjë dyshim të gjitha mundimet, sakrificat dhe gurët e balta, në të përpjetën e reformave, punëve, ndryshimeve të gjithanshme që po e bëjnë Shqipërinë vendin evropian që s'u bë dot për aq shumë e shumë vjet, sa kur e mendon se çfarë malesh me kohë janë tretur në mjegullën e historisë sonë, nuk mund të mos rizgjoresh herët çdo mëngjes, për t'u përpjekur të shtosh ende më shumë ritmin dhe shpejtësinë e ngjitjes drejt majës së lartë, aty ku gjendet shtëpia e madhe e Evropës së Bashkuar, aty ku fëmijët e Shqipërisë, e më pas edhe të Kosovës, nuk do të merren më dot kurrë peng nga e kaluara jonë e përbashkët tragjike.

Përpara pak kohësh erdhi në Tiranë misioni i hulumtimit të NATO-s për të parë nëse kandidatura jonë për Samitin e vitit 2027 plotësonte kushtet me infrastrukturë dhe logjistikë; një eveniment botëror që mbledh në një vend me mijëra njerëz, ku vetëm për Presidentin e Shteteve të Bashkuara mbërrijnë afro 1000 vetë. Përshtypjet e misionit ishin të jashtëzakonshme dhe thjesht të paimagjinueshme, deri pa u ndërtuar gjithë sa është ndërtuar këto dhjetë vjet. Dhe sot ne presim me besim që në Samitin e Hagës vitin e ardhshëm, Shqipëria të shpallet zyrtarisht vendi mikpritës i NATO-s në vitin 2027. 2027-a është edhe viti i objektivit historik, të përcaktuar në planin tonë të përbashkët strategjik me Komisionin Evropian, për të mbyllur negociatat e anëtarësimit në BE dhe për t'i hapur rrugë procesit dyvjeçar të ratifikimeve në parlamentet e vendeve anëtare, të cilat do të votojnë hyrjen e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si anëtare me të drejta të plota në vitin 2030. Edhe kjo, një ngjitje e paimagjinueshme drejt majës që deri 10 vjet më parë nuk shihej dot as me dylbi, ndërsa Shqipëria ishte një dele gjysmë e zezë e gjysmë gri, të cilën nuk e merrte seriozisht askush, jashtë kufijve të saj.

Vitin e ardhshëm, më 16 maj, Samiti i Komunitetit Politik Evropian do të mbahet në Tiranë, ku do të mikpresim udhëheqësit e 700 milionë banorëve të hapësirës demokratike të kontinentit tonë, nga Londra në Ankara, nga Kievi në Lisbonë e nga Helsinki në Prishtinë e deri në Baku dhe Yerevan. Kështu Shqipëria, do të jetë përsëri, epiqendra e një momenti të rëndësishëm të jetës politike evropiane dhe çka më mbush me energji, besim e frymëzim, është fakti se tanimë nuk jemi figurantët e dikurshëm të fotografive e familjare të bashkësisë ndërkombëtare, po jemi anëtarë aktivë e të respektuar të saj, me një rol sa të vetëdijshëm për përmasën e për peshën modeste të vendit tonë në arenën e madhe të politikës evropiane, aq edhe të rëndësishëm e përcaktues për rajonin tonë, i cili sot më shumë se asnjëherë tjetër ka një domethënie të posaçme për Evropën e nesërme.

Të nderuar bashkatdhetarë e qytetarë shqiptarë këtej bjeshkëve tona. Plot njëzet vjet më parë, në vitin 2004 presidenti gjithnjë e më i pranishëm me mungesën e tij në jetën politike të shqiptarëve, Ibrahim Rugova, tha diçka edhe për ne sot, duke na kujtuar se, citoj: “Objektivat e përbashkëta të Kosovës e Shqipërisë janë integrimi në BE, në NATO dhe në miqësi permanente me SHBA-në. E themi me bindje të plotë se shqiptarët në përgjithësi sot janë në rrugë të progresit, janë populli më dinamik në këtë pjesë të Evropës e të botës dhe kanë shansin historik të hyjnë me vlerat e tyre në familjen e madhe evropiane”.

Këto fjalë kaq të thjeshta në dukje janë gjithçka që në fakt na duhet dhe na mjafton, për të mos e humbur nga sytë objektivin historik të bashkimit përfundimtar me familjen e madhe evropiane të të dy shteteve tona, si edhe për të mos e hequr nga mendja se këtë shans historik shqiptarët mund ta shfrytëzojnë me sukses, vetëm si “trimi i mirë me shokë shumë”.

Por, ndërkohë që Shqipëria ecën tanimë me hapa të shpejtë e të pandalshëm në udhëtimin e saj për t’u bashkuar me Evropën, mendoni se sa më krenarë do t’i bënim të gjithë shqiptarët anëmbanë, se çfarë vlere ende më të madhe do t’i jepnim emrit të shqiptarit dhe forcës së shqiptarisë, kudo ku shqiptarët jetojnë, sikur në këtë udhëtim të ishim krah për krah me Kosovën; sikur edhe Kosova të shkëlqente njësoj ndërkombëtarisht duke e hedhur vallen e kësaj kohe të re të shqiptarëve, në një ritëm me pagëzuesit e lirisë dhe bekuesit e pavarësisë së saj; sikur në sofrën e kombeve të Ballkanit të ishim së bashku, në krye të vendit, si një shëmbëlltyrë dinamike e mishërim i vlerave evropiane në këtë rajon, ku mos e harroni kurrë jemi i vetmi komb që flet një gjuhë po aq të vjetër sa vetë gjeneza e Perëndimit.

Dëshira ime e zjarrtë, e patregueshme dot me fjalë, është që të mos jemi njëri në tryezën e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, kurse tjetri në listën e sanksioneve të Bashkimit Evropian, të cilat, meqë ra fjala, sot janë një absurditet absolut dhe së bashku

me presidenten në Samitin me Bashkimin Evropian dy ditë më parë, kemi këmbëngulur me forcë që ato masa të hiqen dhe kemi siguruar që të gjitha fondet e Bashkimit Evropian që janë penguar të lëvrohen për shkak të atyre masave, të mos digjen, por ne duhet të jemi dorë për dorë, paqedashës dhe paqeruajtës për të bindur dora-dorës edhe skeptikët më të mëdhenj në Bashkimin Evropian për absurditetin e rezervave të tyre ndaj njohjes së Kosovës, si shtet sovran, dhe në sytë e tyre barra e fajit për degradimin e dialogut evropian të normalizimit duhet t'i bjerë e gjitha vetëm Serbisë, po kurrsesi nuk duhet të lejojmë që qoftë edhe një gram t'i bjerë Kosovës.

Ne duam që Republika e Kosovës të njihet një orë e më parë nga të gjitha ato vende evropiane që sot e gjithë ditën ngurrojnë ta pranojnë realitetin e pakthyesëm dhe të pandryshuesëm të pavarësisë së saj, përfshirë edhe nga vetë Serbia, të cilën Kosova e ka mundur me luftë këtu e 25 vjet më parë dhe s'ka më asnjë arsye për ta lidhur me të, në asnjë formë e mënyrë, fatin evropian të saj. Ne duam ta ndihmojmë me të gjitha sa kemi në dorë Kosovën në arritjen e objektivit historik aq thjesht e bukur të përcaktuar nga Ibrahim Rugova. Por, mundësitë tona as mund të krahasohen me mundësitë e miqve dhe aleatëve tanë strategjikë dhe pezmatimi i tyre me Kosovën na pengon të bëjmë sa do të donim e do të mundnim të bënim, në këtë kohë kur të gjitha yjet janë rreshtuar në favor të shqiptarëve, të shansit tonë historik si komb shqiptar për t'u bashkuar përmes dy shteteve tona me Evropën.

Më ndjeni ta përsëris sot këtu porosinë e mikut më të madh të Kosovës, të cilit i është ngritur për së gjalli edhe një monument në mes të Prishtinës, Presidentit Bill Clinton, që më kërkoi t'u them të gjithë miqve në Kosovë, se koha nuk e sjell shansin historik përgjithmonë, po e sjell që të mos e humbasim dhe ta kthejmë në një arritje historike për sa kohë e kemi atë në dorë. Unë nuk kam asnjë dyshim se qytetarët dhe forcat politike të këtij shteti, ende të ri, por mjaftueshëm të kalitur në rrugën e lirisë dhe pavarësisë së vet, me talente që mahnitin botën, e me një fuqi të brendshme të jashtëzakonshme, mund ta shndërrojnë atë hartën e verdhë në flamurin blu të Republikës së Kosovës në një yll të ri në flamurin e Evropës së Bashkuar, duke bërë të njëjtën gjë që ne po bëjmë me sukses të pamohueshëm për Shqipërinë, pasi i kthjem edhe skeptikët më kokëfortë të deridjeshëm në mbështetës të besueshëm të ngjitjes sonë drejt majës së objektivit historik të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Lejomëni të ndaj këtu sot opinionin tim, tanimë të konsoliduar në këtë rrugëtim, ku ç' nuk kam parë dhe shumë kam mësuar nga marrëdhëniet me miqtë dhe me aleatët e me jodashamirësit tanë, se në këtë fazë kaq vendimtare për rrugën e saj të integritimit evropian dhe euroatlantik, Kosova duhet ta ngrijë, ta fitohë, pa afat dialogun bilateral me Serbinë dhe normalizimin e marrëdhënieve me fqinjën verior duhet ta synojë përmes dialogut

bilateral me Bashkimin Evropian, duke e këputur kërthizën e reciprocitetit nationalist me Serbinë dhe duke lidhur kërthizën e reciprocitetit evropianist me BE-në.

E thënë ndryshe, Kosova mund t'i japë familjes evropiane dhe Aleancës së Atlantikut të Veriut, në një kohë shumë të shkurtër, provën e padiskutueshme të vullnetit e të përkatësisë së vet në gjirin e Evropës së Bashkuar e të NATO-s, duke i përmbushur, unilateralisht, të gjitha kushtet e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë; jo për hir të Serbisë, po për hir të martirëve dhe të fëmijëve të vet dhe për hir të bashkimit tonë kombëtar në familjen e kombeve evropiane, me kryeqytet të përbashkët Brukselin. Nuk ka asnjë arsye që Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të përpiqen të bindin Kosovën, për qenien e saj organikisht të lidhur me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian, ashtu sikundër nuk ka asnjë arsye që Kosova të presë se ç' do të bëjë Serbia, për të bërë ajo hapat e saj drejt BE-së dhe NATO-s. Kosova e uli në gjuhë Serbinë 25 vjet më parë dhe 25 vjet më vonë duhet ta lerë në bisht Serbinë.

E them këtë për t'i dhënë Kosovës kurrresi jo një leksion, po një opinion vëllazëror dhe konstruktiv për mënyrën se si mësimet e integritit të njërit vend mund t'i vlejné edhe vendit tjetër, që të mos kemi pësime historike, kur sot fatin tonë të përbashkët kombëtar e kemi të gjithin në duart tona dhe krahët i kemi të shtrira nga Mitrovica në Konispol. “Do të udhëtojmë bashkë, të gjithë, ose nuk udhëtojmë. Pa përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk nisemi – sot, as nesër, asnjëherë. Kështu mendojmë të gjithë. Vetëm bashkë”, tha profesor Rexhep Qosja, një prej anëtarëve të delegacionit, pak para se i gjithë delegacioni bashkë me luftëtarët e lirisë, përfaqësi e miliona zemrave shqiptare me plot besim në të drejtën e madhe, qoftë dhe të vonuar, të ndërmerre në orët e fundit të shekullit të vjetër udhëtimit, që ndryshoi përgjithmonë rrugën drejt të sotmes dhe bëri që shekulli i ri i shqiptarëve të lindë me këmishë.

E risolla këtë paragraf nga fjala ime e këtushme dhjetë vjet më parë, sepse më mahnit më rrëqeth aktualiteti i atyre rreshtave prej prijësi shpirtëror, pa asnjë pushtet tjetër përveç pushtetit të fjalës, të cilat Rexhep Qosja i pati shqiptuar në ato çaste vendimmarrjesh të mëdha për Kosovën e për kombin shqiptar. Po ku janë sot përfaqësuesit e UÇK-së që Rexhep Qosja i kërkonte me patjetër në atë udhëtim historik? Pa Hashim Thaçin e shokët e tij, që udhëtuan bashkë me Ibrahim Rugovën, Rexhep Qosen e të tjerët, për të takuar historinë e re të shqiptarëve këtej bjeshkëve, nuk e dimë dot çfarë rruge do të kishte marrë fati i Kosovës në hyrje të këtij shekulli. Por çfarë dimë me siguri është që ato çaste vendimmarrjesh të mëdha nuk do të kishin ardhur dot ashtu siç erdhën dhe mbase e sotmja do t'i ngjante më shumë të shkuarës sesa të ardhmes, pa ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në krye me Hashim Thaçin.

Por, sot që ne jemi të gjithë këtu, në Kuvendin ku u shpall e u firmos këtu përpara meje pavarësia e Kosovës, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli e Rexhep Selimi, vazhdojnë të mbahen peng, prej gati 5 vjetësh, në qelitë e një drejtësie ndërkombëtare, e cila, në çdo hap ka zhgënjyer këdo që ka pritur prej saj virtytet e drejtësisë së një shteti të së drejtës. Unë as nuk e kam diskutuar ndonjëherë dhe nuk e diskutoj as sot të drejtën e asaj Gjykatës Speciale për të bërë punën që ia ka ngarkuar edhe vendimmarrja e kësaj salle, ku vetë Hashimi e ka ngritur dorën për formimin e asaj gjykate.

Por, ajo që unë nuk vij dot deri këtu në Prishtinë, të marr fjalën e pastaj ta gëlltis në heshtje në këtë foltore përpara jush, në mungesë të Hashimit, në mungesë të Kadriut, në mungesë të Jakupit, në mungesë të Rexhepit, - është nyja e mbledhur në fyt prej dyshimit të madh, e krejt i arsyeshëm, për fat të keq, se ai proces është një proces i parregullt ligjor dhe se normat dhe standardet e tij janë nën standardet e drejtësisë të të gjitha vendeve demokratike që e financojnë atë farë gjykate.

Unë nuk rri dot, po ashtu, pa jua thënë këtu vëllazërisht çudinë time për faktin që në këtë sallë nuk është ndërmarrë asnjëherë një nisëm për t'u kërkuar përmes një rezolute të mbështetur nga të gjitha forcat politike, të paktën nga partitë shqiptare, të gjitha vendeve financuese të asaj gjykate shqetësimin e madh mbi standardet e atij procesi dhe për të kërkuar ngritjen e një misioni verifikimi lidhur me këtë shqetësim.

Gjykata është e pavarur, por standardet nuk janë të varura nga gjykatësit.

Ndoshta ky shqetësim gjerësisht i përhapur mund të mos qëndrojë, por nëse qëndron, atëherë kjo është një gjëmë e madhe. Jo për ata 4 njerëz të thjeshtë, as vetëm për Republikën e Kosovës, por për vetë integritetin e drejtësisë ndërkombëtare, së cilës kjo Republikë përmes përfaqësuesve të saj në këtë sallë ia dha në mirëbesim gjykimin e historisë që lindi Republikën dhe prandaj nuk mund të lihet, sipas meje, në heshtjen shurdhuese që ushqehet prej gjithfarë motivesh nga më fisniket, deri tek më politiket që ajo gjëmë, nëse është gjëmë, ta bëjë demin e vet deri në fund.

Gjithsesi unë dua ta dini të gjithë ju këtu dhe ata që na dëgjojnë, që nëse Kuvendi i Kosovës kurdo qoftë do e merrte nismën për t'iu drejtuar të gjitha shteteve sponsorizuese të Gjykatës Speciale dhe për të ndarë me to dyshimin e arsyeshëm për cenimin e standardeve demokratike në procesin ligjor kundër Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit dhe nëse do të na kërkohej që një nismë e tillë t'i bashkohej dhe Kuvendi i Shqipërisë, unë nuk flas dot për të tjerët, por veç për forcën time politike, Partia Socialiste do ta angazhojë pa asnjë ngurrim që të njëjtën rezolutë të votuar nga Kuvendi i Kosovës, ta depozitonte në Kuvendin e Shqipërisë.

Të nderuar kryetarë të dy kuvendeve, qytetarët e Kosovës tanimë janë në momentin e gjykimit të forcave politike, të cilat kanë hyrë në garën demokratike të kërkimit të votës së tyre për të qeverisur Kosovën në katër vjetët e ardhshme, prandaj unë kam shumë besim që kjo sallë dhe kush më dëgjon prej jashtë saj do të më mirëkuptojë pse nuk fola këtu sot konkretisht për punët e mira që kemi bërë së bashku me qeverinë e Kosovës mbi themelet e ndërtuara nga bashkëpunimi me qeveritë e mëparshme dhe si vazhdim i punëve të mira të nisura qysh në vitet e para të qeverisjes sonë në Shqipëri, ku edhe ngritëm bashkëpunimin ndërqeveritar me Kosovën në një nivel krejt tjetër nga terreni folklorik ku ishte më parë.

Në mbyllje të kësaj fjale dua të shpreh konsideratën time për bashkëpunimin mes dy trupave përfaqësuese të dy shteteve tona dhe të falënderoj të gjithë deputetët e të dyja palëve që janë angazhuar në fuqizimin e bashkëpunimit parlamentar.

Falë tyre është hedhur dhe në këtë drejtim gjatë këtyre viteve të fundit një bazë e shëndoshë për ta thelluar më tej këtë bashkëpunim, i cili ka ende një potencial shumë të madh për t'u çliruar.

Ju falënderoj të gjithëve për vëmendjen. Uroj më të mirat për të gjithë ju dhe uroj me gjithë zemër që viti që po troket, të jetë një vit i jashtëzakonshëm për nga mirësia dhe për nga sukseset për gjithë popullin tonë, këtej dhe andej bjeshkëve. Faleminderit!

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: E falënderojmë kryeministrin Rama për fjalën e tij.

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Albin Kurti, që të marrë fjalën.

Urdhëroni, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI: E nderuar Presidente e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani - Sadriu,

E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, znj. Elisa Spiropali,

I nderuar kryeministër i Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama,

I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca,

Të nderuar deputetë të dy republikave tona demokratike e parlamentare,

Të nderuar drejtues e përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore,

Shkëlqesi ambasadorë dhe ju diplomatë të tjerë,

Të dashura familje të dëshmorëve, invalidë e veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Të dashur qytetarë,

Sot në Prishtinë moti është i ftohtë, siç i takon në këto javë të mbylljes së vitit, por besoj se ai nuk ndikon aspak në atmosferën e ngrohtë në këtë sallë, ku janë bërë bashkë dy kuvende, ai i Shqipërisë dhe ai i Kosovës. Dhe nuk ka si të ndodhë ndryshe. Dy republikat tona janë parlamentare dhe ju, të dashur deputetë, përfaqësoni qytetarët e dy shteteve dhe pjesëtarët e të njëjtit komb. Dy shtetet tona, edhe pse të themeluara me një distancë kohore nga njëri-tjetri, janë shprehje politike e së njëjtës aspiratë shekullore të shqiptarëve për ruajtjen e identitetit dhe bashkimin kombëtar. Legjislatura e parë e Kuvendit të Shqipërisë e dalë nga zgjedhje pluraliste e njohu shpalljen Republikës së Kosovës me rezolutën e datës 21 tetor 1991. Ndjenja e vëllazërisë, vetëdija historike dhe përgjegjësia para qytetarëve që na kanë zgjedhur për t'i përfaqësuar, motivojnë mbledhje si këto.

Si kryesues i Qeverisë së Kosovës, shpreh kënaqësi që sot Kuvendet e dy shteteve bëjnë bilancin dhe vlerësimin e marrëveshjeve të nënshkruara në mbledhjet e përbashkëta qeveritare dhe që besoj se mbulojnë të gjitha fushat e veprimit shtetëror: që nga mbrojtja; infrastruktura; bujqësia; shkëmbimet tregtare; tregu i përbashkët energjetik; turizmi; lëvizja ndërkufitare pa kontrolle; njohja e kontributeve shoqërore për efekt të pensioneve; njësimi i teksteve shkollore; organizimi i veprimtarive të përbashkëta artistike e sportive; reduktimi i procedurave administrative për banim, studim, punësim e sipërmarrje e të tjera, e të tjera. Rezultatet e deritanishme të këtyre marrëveshjeve janë të prekshme për qytetarët dhe nxitëse për të vijuar më tej në këtë rrugë. Më lejoni të përmend vetëm disa nga arritjet e përbashkëta:

- Shqipëria është ndër pesë vendet e para me të cilët Kosova ka vëllimet më të mëdha të shkëmbimeve tregtare dhe partneri kryesor tregtar i Kosovës për vitin 2023 me vlerën 440 milionë euro;
- Tregu i përbashkët energjetik ALPEX “Albanian Power Exchange” është funksional;
- Lëvizja pa asnjë kontroll e qytetarëve në kufi për një periudhë 9-mujore dhe gjatë fundjavave e festave shtetërore edhe për tre muajt e mbetur, ndërkohë që po punohet për heqjen e kontrollit përgjatë tërë vitit;
- Lehtësimi i procedurave të kontrollit të produkteve me origjinë joshtazore në pikat e inspektimit kufitar;
- Hapja e 26 vendkalimeve të reja për mbi 200 mijë banorët e zonave kufitare dhe rehabilitimi i disa segmenteve rrugore të fshatrave kufitare Shqipëri-Kosovë;
- Hapja e dy zyrave doganore të Kosovës në Durrës e Porto Romano dhe reduktimi i skanimit të dyfishtë nga 100% në 10%;
- Hapja e korridoreve të reja ajrore për fluturime komerciale që kanë shkurtuar fluturimet për dhe nga Kosova;
- Ofrimin e shërbimeve mjekësore nga spitalet e zonave kufitare Kukës, Gjakovë, Prizren për banorët e tyre;

- Bashkëpunimi në aplikimin e suksesshëm të Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare në vitin 2030 dhe bashkorganizimi i Kampionatit Evropian të Volejbollit për vajza të grupmoshave U16;
- Fondi i përbashkët për projektet teatrale dhe organizimi i festivalit mbarëkombëtar i teatrit shqiptar “Moisiu”;
- Veprimtari të shumta të përbashkëta në kinematografi, trashëgimi kulturore e muze;
- Abetarja e njëjtë mësohet në shkollat tona tash e tre vjet dhe vijon bashkëpunimi për hartimin e “Enciklopedisë shqiptare”;
- Njësimi i procedurave për regjistrimin e studentëve dhe dhënia e bursave;
- Lehtësimi i procedurave të transitit të mallrave ushtarake dhe teknologjisë me përdorim të dyfishtë;
- Bashkëpunimi për operacionet në fushën e kërkim-shpëtimit në të dy vendet;
- Platforma e përbashkët digjitale e informacionit dhe promovimit turistik, e të tjera.

Të dashur deputetë të kuvendeve tona,

Jemi të vetëdijshëm se nuk na lejohet mburrja dhe vetëkënaqësia për arritjet. Kemi shumë punë për të bërë, si Qeveri, si kuvende dhe si administrata publike për të lehtësuar bashkëpunimet e natyrshme midis qytetarëve të dy republikave tona. Sepse, siç e ka thënë poeti dhe prozatori ynë i mirënjohur, Primo Shllaku: “Kufiri ndërmjet Kosovës e Shqipërisë është si kufiri ndërmjet dy barkusheve të zemrës”. E kuvendet kanë rol të rëndësishëm për miratimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe po ashtu edhe për monitorimin e zbatimit të tyre.

Komisionet e përbashkëta parlamentare të ngritura enkas për marrëdhëniet dhe marrëveshjet midis dy shteteve besoj se do të ndihmonin në këtë drejtim. Kemi punë përpara, jo vetëm ndaj qytetarëve tanë, por dhe për ndihmuar për sigurinë e jetesën e dinjitetshme të shqiptarët në shtetet fqinje, në Maqedoni të Veriut, në Mal të Zi, por sidomos në Luginën e Preshevës, në Serbi. Shqiptarët nën Serbi janë komuniteti etnik më i diskriminuar në Evropë, prandaj ata meritojnë vëmendje më të madhe në bashkërendimin e politikave rajonale të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës. Shqiptarët nuk janë fajtorë që janë autoktonë.

Në buxhetin e vitit të ardhshëm kemi ndarë si Qeveri e Kosovës katër milionë euro për Luginën e Preshevës. Uroj të shërbejë kjo si një shembull edhe për Shqipërinë!

Shqipëria dhe Kosova aspirojnë të jetë anëtare të denja të familjes euro-atlantike dhe po marrin përgjegjësinë që u takon në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Pakicat kombëtare në Kosovë dhe të shqiptarët në përgjithësi janë bashkë me ne, sepse ne jemi respektues dhe të përgjegjshëm ndaj tyre. Kosova dhe Shqipëria besojnë në të drejtat e njeriut, janë kontribuese të paqes dhe të sigurisë në rajonin e Ballkanit

Perëndimor, prandaj dhe janë mbështetës të fuqishëm të proceseve integruese euro-atlantike. Sot më shumë se kurrë shtetet demokratike në kontinentin tonë po ndërgjegjësohen se kanë nevojë si për Bashkimin Evropian, si për NATO-n. Jo më kot, dy vendet anëtare të Bashkimit Evropian, Finlanda dhe Suedia, kohët e fundit vendosën që t'i bashkohen Aleancës së Atlantikut Verior. Neve në Kosovë na gëzon fakti që Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe vend kandidat i Bashkimit Evropian. Kosova ka dorëzuar aplikimin për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian dhe po avancon në këtë drejtim, për aq sa lejon situata ku ajo ndodhet, kryesisht për shkak të refuzimit agresiv të Serbisë për të na njohur si shtet, por edhe për shkak të mosnjohjes nga pesë vendet anëtare të BE-së. Ndërkaq NATO-ja është në Kosovë, Kosova nuk është ende në NATO. Mirëpo, Kosova po bën hapa gjigantë drejt NATO-s. NATO nuk ka armatim të vetin, NATO e ka vetëm armatimin e shteteve anëtare dhe për dallim nga viti 2018-2020 kur kishin më pak se katër milionë euro investim në armatim, në vitet 2021-2023 kemi mbi 239 milionë euro investim në armatim dhe municion. Pra, ne nuk mund të anëtarësohemi në NATO se nuk jemi mjaftueshëm të fortë, por do të anëtarësohemi sepse do të bëhemi gjithnjë e më të fortë dhe nga NATO të përfitojmë, sepse edhe do të kontribuojmë.

Agresioni i Ruisë në Ukrainë, rindezja e konflikteve në Lindjen e Mesme, sulmet terroriste ndaj Kosovës, ai në Banjskë dhe ky i fundit në kanalin Ibër-Lepenc, që vijnë nga e njëjta adresë, Serbia, e nëse nuk është Serbia, është edhe Serbia dhe Rusia bashkë, e kanë bërë këtë çështje urgjente, pra anëtarësimin e Kosovës në NATO. Forcat e Sigurisë së Kosovës është në lartësinë e detyrës që kërkojnë standardet e Aleancës dhe ne besojmë se Shqipërinë e kemi në krah të përpjekjeve tona për të tejkaluar pengesat politike ndaj anëtarësimit të Republikës së Kosovës në këtë organizatë.

Qysh në vitin e kaluar, edhe në këtë vit, edhe vitin e ardhshëm ne tejkalojmë kriterin prej 2 për qind të bruto produktit vendor që është i vendosur në samitin e Wales-it para 10 vjetëve të NATO-s kur u përcaktua si kriter. Edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri të nderuar deputetë, të dashur kolegë nga ekzekutivi, besoj që duhet t'u kushtojmë rëndësi të posaçme katër kategorive shoqërore: aktivizimit dhe të drejtave të grave që na e dyfishojnë kombin, rinisë që është energjike dhe shumëgjuhëshe si asnjë tjetër në Ballkan, diasporës që është më e madhe dhe patriotike, sërish, si asnjë tjetër nga Ballkani, dhe zhvillimit të fshatit e të malësive tona. Në Kosovë, rritja ekonomike mesatare në këtë katërvjeçar ishte më e larta prej se kemi shpallur pavarësinë, e po ashtu edhe avancimi demokratik, luftimi i korrupsionit e progresi shoqëror. Gjithashtu si asnjëherë më parë kemi shtrirë sovranitetin në veri të Kosovës, kemi integritet territorial dhe sot që po flasim në Kosovë mund të ketë akte sporadike terroriste, por nuk ka më burime të brendshme që mund të na cenojnë sigurinë apo stabilitetin.

Terrorizimi i paramilitarëve të orkestruar e të financuar nga Serbia është shprehje e pafuqisë së tyre. Dikur nuk kanë bërë akte terroriste, sepse e kishin krejt në kontroll, tash që e kanë humbur kontrollin, bëjnë akte terroriste, por ky është fundi i tyre. Aktet e tyre terroriste janë dëshpërimi i tyre, janë fundi i sundimit të tyre.

Të nderuar të pranishëm,

Vitin tjetër, kuvendet e Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Shqipërisë do të riformohen, sipas vullnetit që qytetarët do të shprehin në kutitë e votimit. Cilët do qofshin deputetët që do t'i përfaqësojnë, unë jam i sigurt se mbledhjet e përbashkëta të dy kuvendeve do të vijojnë me të njëjtën frymë dhe dobi publike, sikurse kjo mbledhje e sotme.

Falënderoj dy kryetarët e kuvendeve, znj. Spiropali dhe z. Konjufca, për organizimin e saj, falënderoj kryeministrin e Shqipërisë, z. Edi Rama, për pjesëmarrjen e tij, kryetarët e grupeve parlamentare, deputetët e pranishëm dhe të gjithëve bashkë ju uroj ditë të mbarë!

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Faleminderit kryeministër Kurti për fjalën tuaj drejtuar dy kuvendeve.

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: Tash, të nderuar kolegë, po fillojmë me grupet parlamentare të dy kuvendeve tona dhe fillimisht po ia jap fjalën zonjës Mesila Doda, kryetare e Grupit Parlamentar Demokraci dhe Integrim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

MESILA DODA: Ju faleminderit!

E nderuar zonja Presidente,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Kryetarë të kuvendeve, përkatësisht të Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës,

Të nderuar zotërinj kryeministra të Kosovës dhe Shqipërisë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Është pa dyshim nder i veçantë për secilin nga ne pjesëmarrja në këtë seancë, qysh prej dy vjetësh kur për herë të parë ne u bëmë bashkë në sallën e Parlamentit të Shqipërisë me rastin e festës së pavarësisë, sot është hera e dytë që dy parlamentet, dy kuvendet janë së bashku dhe për herë të parë në Prishtinë.

Sot ne mund të zgjedhim dhe të flasim për të kaluarën tonë të përbashkët dhe luftarake, por nevoja jonë për Kosovën dhe e Kosovës për Shqipërinë nuk është histori e shekullit të kaluar, nuk është as ajo e para 100 vjetësh që mbajti mbi vete traumën e ndarjes së trojeve, dhe nuk është as ajo e para 20 vjetësh kur mori jetë shteti më i ri në Evropën e lashtë. Ne sot duhet të nisim të shkruajmë një histori të re dhe moderne, dy vende që

drejtohen nga e ardhmja me një qëllim madhor të bëhen bashkë dhe të jenë bashkë, ashtu siç ishte projekti i Zotit kur e krijoi, ashtu siç përcaktohet në preambulën e Kushtetutës tonë.

Më së pari dua ta nisim nga mendja, ne duhet të jemi së bashku në mendje. Askush nuk e pengon të krijojmë akademinë e shkencave të kombit, e mundësisht të kemi njerëz, të cilët janë ekselentë, një grua, për shembull, siç është Mira Murati, e cila është në majën e shkencës të botës, do të nderonte një personazh i tillë krijimin e një akademie të kombit, po vetë figura të tilla të cilat na përfaqësojnë dhe e çojnë kombin nga majat e dijes moderne.

Ne sot kemi nevojë të koordinojmë zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës, në mënyrë që së bashku të arrijmë të jemi një treg atraktiv, katër milionë kanë mbetur shqiptarët në të dy anët e kufirit, dhe ne nuk mund të ekzistojmë më veçërisht, sepse të ndarë jemi të dobët dhe të varfër. Kombi ynë do të drejtohet nga prodhimi, nga teknologjia e avancuar, nga prodhimi vendas bujqësor cilësor, i cili duhet të shoqërohet me një turizëm bregdetar dhe malor, siç është ai për Kosovën dhe që duhet të shihen se e njëjta paketë e mbi të gjitha afrimi i programeve mësimore për të rinjtë.

Ende ne nuk kemi programe mësimore të njësuara dhe kjo është mënyra më e thjeshtë dhe efektive që të afrojmë të rinjtë tanë në të dy anët e kufirit. Unë besoj që nga këtu duhet të nisë historia e re që duhet të shkruajmë në këtë shekull. Po i lëmë heronjtë Ismajl Qemajlin, Isa Boletinin në lavdinë e tyre, ata e kanë kryer luftën dhe betejën në kohë të errëta. Ne sot kemi sfida të tjera, kemi ekonominë, e cila është sprovë e të dy qeverive, kemi mendjen e mençur të të rinjve dhe të rejave tona që janë kapitali ynë më i çmuar dhe që duhen ndihmuar të realizohen në vendin e tyre. Ne sot duhet të jemi një në politikën e jashtme dhe të llojmë fort për të ecur përpara në rrugën e integritit dhe, mbi të gjitha, kemi detyrë të afrojmë brezat e rinj.

Kufiri mes nesh nuk është zgjedhja jonë, por është zgjedhja jonë që ta bëjmë atë të pavlefshëm. Dikur Shqipëria shtrihej nga Gjiri i Artës deri te Molla e Kuqe, sot shtrihet nga Konispoli në Merdar, kufiri mes nesh nuk vlen, siç thotë dhe baca Isë pasi mori lajmin se Kosovën e lanë jashtë kufijve të shtetit shqiptarë, “ani, gurët e kufirit hiqen e vihen, por Kosova ka me mbet gjithmonë shqiptare”.

Lavdi Republikës së Kosovës! Lavdi kombit shqiptar! Lavdi luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Lufta mbetet e paprekshme. Ju faleminderit!

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Ftoj për fjalën e tij zotin Ramush Haradinaj, kryetar i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

RAMUSH HARADINAJ: E nderuar Presidente Osmani,
Të nderuar deputetë të dy kuvendeve tona, të Shqipërisë dhe të Kosovës,
E nderuar kryetare Spiropali e kryetar Konjufca,
I nderuar kryetar i Qeverisë së Shqipërisë, kryeministër Edi Rama,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar familjarë të dëshmorëve,
Kor diplomatik e media,
Të dashur bashkëkombës kudo që jeni,
Ky takim i sotme vërtet është midis vëllezërve e motrave dhe në një takim të tillë nuk duhet të fshihet e vërteta. Situata e sigurisë në Kosovë është e brishtë dhe për të parën herë në këto njëzet vjet na është sulmuar një pjesë e vendit nga grupet terroriste e të armatosura me arsenal ushtarak. Hapa të gabuar e të pakoordinuar të Qeverisë së Kosovës, të kryeministrit të Qeverisë së Kosovës me partnerët strategjikë, posaçërisht SHBA-në, për integrimin e serbëve të veriut, kanë bërë që Serbia dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare të shihet si viktimë, e Kosova, thënë më së buti, e papërgjegjshme dhe shtet joserioz. Si pasojë, Kosova është vënë nën sanksione të Bashkimit Evropian dhe Amerikës. Pra, Kosova është në të njëjtin thes me Korenë e Veriut nga kryeministri Kurti dhe Qeveria e tij.

Edhe pse ishim në hapat e fundit dhe Qeveria Kurti e zbatoi vendimin e Gjykatës për bartjen e pronave për Manastirin e Deçanit, prapëseprapë na u pamundësua anëtarësimi në Këshillin e Evropës, pikërisht si pasojë e politikës së Qeverisë Kurti. Prej saj jemi përjashtuar edhe nga Defender 2023. Janë ndalur njohjet ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, është zbehur bashkëpunimi me aleatët perëndimorë.

Me një fjalë, kurrë nuk kemi pasur marrëdhënie më të ftohta me partnerët tanë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar dhe të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Kryeministri ynë ka shkuar deri aty sa Sekretarin Amerikan të Shtetit, Blinken, e ka quajtur “naiv”. Prandaj, jemi këtu ku jemi.

Të nderuar deputetë e ju të tjerë të pranishëm,
Në vendin tonë, tenderët njëburimorë janë kthyer në gjakderdhje financiare të buxhetit. Në vendin tonë janë vjedhur rezervat shtetërore. Është vjedhur mielli e vaji, është vjedhur energjia, e pasulin e shpallur sekret shtetëror e ushtria jonë ka mbetur pa bukë e pa paga të dinjitetshme. Ushtria është krijuar më 2018 me një plan dhjetëvjeçar e me parakontrata qindmilionëshe, të cilat i ka bllokuar kryeministri, që sapo mashtrroi më herët për investimet në mbrojtje.

Numri i të rinjve që po e braktisin vendin është i frikshëm. Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të popullsisë, që janë publikuar dje, Kosova ka vetëm 1.6 milionë banorë. Para tridhjetë vjetësh i kishte një milion e nëntëqind mijë.

Vargu i dështimeve është i gjatë dhe fatkeqësisht vështirë e kemi të gjejmë qoftë edhe një punë të hairit. Unë mendoj se çdo veprim i Kurtit është në përputhje të plotë me agjendën e Serbisë dhe të Ruisë. Dora e tij përçarëse ka depërtuar edhe te bashkëkombësit tanë në Maqedoni e në Preshevë. Bile, e bëri edhe një përpjekje në Shqipëri, po ju nuk e latë.

Për të qenë i sigurtë dhe i hapur me ju.

Kryeministër dhe kryetare Spiropali, marrëdhëniet me Shqipërinë në këto katër vjet gati sa nuk e kanë prekur fundin. Secili në këtë sallë e di shkakun, pra pse janë kështu.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të mira janë mbledhjet tona vëllazërore, pra të përbashkëta, të qeverive e të parlamenteve, megjithëse jo bash të hijshme në prag të zgjedhjeve. Por, me Shqipërinë është ndryshe, sepse vëllai te vëllai shkon e vjen kur të dojë edhe befasishëm. Pra, çdo herë është ndjenjë e mirë të jemi bashkë.

Si përfundim, e dimë që Shqipëria ka bërë kujdes e nuk është përzier në ato fushatat e tona të brendshme zgjedhore. Ne do ta vazhdojmë këtë respekt të ndërsjellë, por e kërkojmë ndihën e Shqipërisë në diçka që është jetike për Kosovën, për sigurinë tonë të përjetshme, ndihmën për anëtarësimin direkt në NATO dhe atë jo përmes partneritetit për paqe, sepse është i konsumuar me planin dhjetëvjeçar për krijimin e ushtrisë, ju lutem, por përmes planit aksional të anëtarësimit.

Rroftë Kosova, rroftë Shqipëria!

Rrofshin shqiptarët dhe rrofshin ata që na ndihmuan në luftë, pra NATO dhe Amerika!

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: Tash fjalën po ia jap z. Fatmir Mediut, nga Grupi Parlamentar Aleanca për Ndryshim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

FATMIR MEDIU: Të dashur motra dhe vëllezër,

Drejtues të Kuvendit të Kosovës,

Drejtues të qeverive,

Motra dhe vëllezër të Kosovës,

Sot krenar në këtë foltore të Kuvendit të Kosovës përulem së pari me respekt të thellë përball heronjve të kombit të Kosovës në mënyrë të veçantë, Adem Jasharit dhe Ibrahim Rugovës, dhe të gjithë luftëtarëve që sakrifkuan jetën për çlirimin e Kosovës.

Përulëm ndaj atyre që padrejtësisht ndodhen në Hagë dhe të gjithë ne duhet të mbrojmë historinë dhe luftën e Kosovës. Mirënjohje të përjetshme Shteteve të Bashkuara të Amerikës, NATO-s, Presidentit Klinton në radhë të parë, i cili udhëhoqi NATO-n kundër gjenocidit serb, Presidentit Bush i cili nga Tirana në 2007 shpalli mbështetjen e Pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, dy nga arritjet më madhore të kombit tonë që nga shpallja e pavarësisë. Një reflektim edhe për veten tonë, ne jemi zgjedhur që t'u shërbejmë shqiptarëve dhe interesit kombëtar, duke i parë ata përballë dhe jo nga lartë poshtë. Ne nuk jemi as të parët, as të vetmit dhe nuk do të jemi as të fundit. Vlera jonë në radhë të parë si njerëz dhe pastaj si politikanë nuk është tek titulli i deputetit apo i qeveritarit, por sa kemi bërë dhe do të bëjmë, qoftë sadopak, por me respekt dhe dashuri e përulësi për Kosovën dhe për shqiptarët.

10 vjet më parë, të dashur kolegë deputetë, Shqipëria ishte vend anëtar i NATO-s, dhjetë vjet më parë, të nderuar kolegë deputetë, Shqipëria lëvizte pa viza në Bashkimin Evropian, dhjetë vjet më parë Kosova ishte e pavarur dhe këto nuk ishin dhuratë, por ishin mund, punë dhe bashkëpunim dhe që të ndërtojmë histori duhet të dimë dhe ta vlerësojmë atë që është bërë më parë. Po ashtu, uroj dhe shpresoj të nderuar kolegë deputetë, të kuptojmë se largimi i rinisë, largimi i profesionistëve dhe dezintegrimi i familjes shqiptare është plaga më e madhe që duhet kuruar sa më shpejt.

Të nderuar kolegë,

Situata që ndodhemi sot nuk është e lehtë dhe asgjë nuk duhet marrim të mirëqenë. Rruga e vetme për të përballur sfidat është të qëndrojmë dhe punojmë së bashku, jo për pushtet, por për shtet. Ndryshimet e mëdha gjeopolitike po influencojnë Evropën, Ballkanin dhe pa dyshim edhe ne. Prandaj është e rëndësishme të dalim jashtë klisheve dhe të adaptohemi në qëllimin tonë të palëkundur të aleancës euro-atlantike, ndërtimi i strukturave, bashkëpunimi në fushën e sigurisë, inteligjencës është jetik sot më shumë se kurrë. Ekonomia, teknologjia, energjia dhe infrastruktura dhe jo vetëm ushtria janë sot më shumë se çdoherë tjetër siguri.

Bashkëpunimi ndërshqiptar, ndërmjet edhe parlamenteve në Shqipëri, Preshevë, Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni është sot një domosdoshmëri. Serbia e ka bërë zgjedhjen e saj, të jetë në një bosht politik dhe ushtarak me Rusinë dhe me Kinën dhe pa dyshim ky është një bosht i provuar qartë kundër interesave të shqiptarëve. Synimi i saj është të krijojë Serbinë e madhe, përmes destabilizimit të rajonit dhe të Kosovës në veçanti, por dhe me mbështetjen e aleatëve të saj. Po sjell në kujtesë, të nderuar kolegë deputetë, një intervistë të fundit të Presidentit Vuçiq në "Hard Talk" BBC. Deklaroi se sipas një thënies serbe "vetëm gomarët nuk ndryshojnë veten e tyre", referuar qëndrimeve të tij viteve më parë, por në vazhdim tregoi se nuk heq dorë nga projektet e zgjerimit të influencës dhe krijimit të asaj quhet Serbia e popullatës serbe.

Mohoi gjenocidin në Srebrenicë dhe në Kosovë, deklaroi se Republika Serbe nuk është pjesë e Serbisë, por as nuk dënon dhe as nuk mohon shkëputjen që kërkohet të bëhet nga Bosnjë e Hercegovina. Deklaroi se Evropa dhe NATO janë hipokritë, kur deklarojmë për mbrojtjen e integritetit territorial të Bosnjës dhe akuzon se ata kanë cenuar integritetin e Serbisë, duke ndërhyrë ushtarakisht dhe mbështetur pavarësinë e Kosovës. Deklaroi hapur dhe prerë: Serbia nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës, një pakt për paqe në luftën në Ukrainë e sheh si shpresë se do të ketë ndikimin për interesat proserbe në Ballkan dhe veçanërisht në Kosovë.

Beogradi, mik i Tiranës dhe kundërshtari i Prishtinës, është me pasoja, të nderuar kolegë deputetë, për interesat tona kombëtare. Më shumë akses ekonomik dhe politik të Beogradit në Ballkan, do të thotë më shumë akses për sa i përket Ruisë dhe Kinës. Si shqiptarë kemi përgjegjësinë të ndërtojmë të ardhmen tonë dhe jo thjesht ta vëzhgojmë atë. Një komb, një qëndrim! Kosova duhet të udhëheqë të ardhmen e saj dhe Shqipëria duhet ta mbështesë atë pa asnjë lloj tendence paternalizmi. Shqipëria duhet të mbështesë në çdo hapë diplomacinë e Republikës së Kosovës, diplomaci e cila është nevojë ekzistenciale për zgjidhjen e problemeve të saj. Dialogu Prishtinë - Beograd duhet të synojë njohje reciproke dhe prandaj përfshirja e fuqishme e Evropës dhe në mënyrë të veçantë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është jetike. Për më tepër që diplomacia e miqve tanë po del nga kuadri i saj klasik. Shqipëria është vend anëtar i NATO-së, e duhet të ketë primare bashkëpunimin me vendet e NATO-s në rajonin e Ballkanit, duke përfshirë edhe Kosovën. Ky bashkëpunim do të duhej të ndërtohej në dakordancë të qartë ekonomike, politike dhe ushtarake, në bashkëpunim me SHBA-në dhe BE-në përballë kërcënimeve që vijnë nga boshti tjetër.

Kërcënimet e sigurisë në Ballkan duhet diskutohen në radhë të parë dhe të vlerësohen me vendet e tjera të NATO-s në Ballkan, sepse ata mbajnë të njëjtin shqetësim si ne në lidhje me kërcënimet në Bosnjë, në Kosovë dhe në Malin e Zi. Kjo do na bënte si shqiptarë të kemi të njëjtën qasje, por edhe të ktheheshim në faktor më i rëndësishëm në politikën dhe në marrëdhëniet me Uashingtonin dhe Brukselin për të garantuar dhe siguruar paqen dhe stabilitetin në rajonin e Ballkan. Duke vlerësuar si parësore procesin e Berlinit, mendoj se qeveritë shqiptare dhe ne si parlamente duhet të përfshihemi në iniciativën e tre deteve, si një nga iniciativat më të rëndësishme të mbështetur edhe nga Presidenti Trump, për të frenuar ndikimin e Ruisë dhe Kinës në Evropë, iniciativë me rëndësi strategjike për energjinë, teknologjinë dhe infrastrukturën. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s para disa ditësh deklaroi se ne duhet të jemi të përgatitur si në luftë dhe 2% nuk janë mjaftueshëm, i njëjti qëndrim vjen edhe nga SHBA-ja.

Prandaj, jo më pak, madje shumë më i rëndësishëm është bashkëpunimi dhe ndërveprueshmëria ushtarake me vendet e NATO-s në Ballkan për të rritur masat mbrojtëse dhe reagimin e përbashkët dhe sa më të shpejtë, por dhe për t'i bërë shpenzimet e mbrojtjes më efikase dhe përveç situatën përfshirja e Kosovës është domosdoshmëri. Artikulli i pestë i aleancës së NATO-s kërkon, nga ana tjetër, një bashkëpunim ushtarak në rajon nëpërmjet politikave Smart Defends, siç ndodh në vendet baltike për t'i bërë ballë çdo provokimi dhe çdo marrje. Armatosja dhe shpenzimet marramendëse të Serbisë mbi 3% të buxhetit mbështetur nga Kina dhe Rusia nuk janë as lojë dhe as teatër politik. Prandaj, të mos jemi vëzhgues, por të jemi veprues të gjithë së bashku në shërbim të interesit kombëtar.

Zoti i bekoftë shqiptarët dhe Kosovën!

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, për folësit e tjerë ju kisha lutur të qëndrojnë brenda minutave që i kemi caktuar, sepse është planifikuar që kjo mbledhje të përfundojë në orën 13:00, po zgjat pak më shumë.

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Duke iu bashkuar kryetarit Konjufca në thirrje, ftoj për fjalën e tij zotin Enis Kervan, kryetar i Grupit Parlamentar Multi-etnik, Kuvendi i Kosovës.

ENIS KERVAN: Të nderuar të pranishëm, është e padiskutueshme nder i madh për mua të jem këtu sot përpara jush në këtë seancë të përbashkët historike të Parlamenteve të Kosovës dhe Shqipërisë, një dëshmi e fortë e lidhjes së palëkundur mes dy vendeve. Historia, kultura dhe aspiratat tona na lidhin me një mënyrë që i tejkalojnë kufijtë dhe na bashkojnë në një të ardhme të përbashkët evropiane.

Sot, pra në këtë mbledhje të përbashkët po e forcojmë këtë lidhje të veçantë. Si kryetar i Grupit Parlamentar Multi-etnik në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si deputet që mbrojmë dhe përfaqësojmë interesat e komuniteteve turk, boshnjak, ashkalinj, egjiptian dhe rom, dëshiroj të vë theksin të rëndësishëm e mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Vendi ynë, Kosova, është shembulli më i shkëlqyer kur kulturat, traditat dhe gjuhët e ndryshme kanë bashkëjetuar për shekuj me radhë. Kjo bashkëjetesë nuk është vetëm pjesë e së kaluarës sonë, por ajo është një vlerë e çmuar e së tashmes dhe të ardhmes sonë. Fuqia e Kosovës qëndron në diversitetin e saj dhe është detyra jonë të sigurojmë që të gjitha komunitetet, pa marrë parasysh përmasat e tyre në numra, pavarësisht nga kombësia e tyre apo dallimet gjuhësore, të ndihen të respektuar dhe gjithsesi të përfaqësuara denjësisht bashkërisht.

Në këtë frymë të unitetit dëshiroj gjithashtu të theksoj rëndësinë jetike të marrëdhënieve të ngushta midis Kosovës dhe Shqipërisë. Bashkëpunimi ynë nuk është thjesht simbolik, ai është jetik për përparimin tonë të përbashkët. Shfrytëzoj rastin ta uroj Shqipërinë për hapjen e grup kapitullit VI të negociatave për anëtarësimin në BE, ndërsa Kosova vazhdon rrugën e saj drejt integritit të plotë në BE dhe në NATO, ku mbështetja e Shqipërisë do të jetë e paçmueshme. Përvoja dhe përkrahja e Shqipërisë do t'i ndihmojë Kosovës të kalojë me sukses këto procese duke na sjellë më afër një të ardhme, në të cilën Kosova do ta zërë vendin e saj të merituar në mesin e vendeve evropiane. Këtu patjetër dua të shpreh një falënderim të veçantë për delegacionin shqiptar në Këshillin e Evropës, ku ne si delegacion i Kosovës dhe i Shqipërisë bashkërisht ditë e natë kemi punuar shkëlqyeshëm dhe kemi arritur suksese të mëdha. Prandaj, faleminderit, kemi këtu edhe deputetë nga delegacioni shqiptar mes neve.

Jam i bindur që ne, Kosova dhe Shqipëria, do të punojmë së bashku si partnerë duke dhënë kontribut të rëndësishëm në ndërtimin e një të ardhmeje, ku paqja, mirëqenia dhe përfshirja do të jetë shtyllat kryesore të gjithë rajonit. Dhe, për në fund, u bëj thirrje kuvendeve, por edhe qeverive të dy vendeve që të angazhohen më shumë për konceptimin e projekteve të përbashkëta në fusha kyçe, si infrastrukturore, ekonomia, shëndetësi dhe arsimi, të cilat forcojnë më tej bashkëpunimin dhe do të sjellin përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë. Faleminderit!

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Ftoj për fjalën e tij zotin Arben Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,

I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Konjufca,

Të nderuar kryeministra,

Të nderuar deputetë,

Vëllezër dhe motra,

Sot ndonëse Kuvendi po duket i madh, konsideroj se më shumë po duket natyral. Si përfaqësues të qytetarëve nga të dyja vendet tona jemi bërë bashkë, jemi ulur bashkë, ngase zëri i qytetarëve tanë nga të dy vendet tona natyrshëm na kërkon për të punuar bashkë e për të bashkëpunuar pandalshëm.

Motra dhe vëllezër, po, historinë e kemi bashkë, po, kulturën e kemi bashkë, gjuhën shqipe e kemi bashkë, po, miqtë e kombit i kemi bashkë, po, figurat kombëtare i kemi bashkë, pra krejt i kemi bashkë. Prandaj në punë dhe angazhim duhet të jemi bashkë, veç nëse e heqim pak inatin.

Pasi të gjitha na bashkojnë, atëherë le t'i bashkojmë të gjitha për punë dhe angazhim. Duhet bashkëpunuar thellësisht e praktikisht mes dy vendeve në fushën e sigurisë, mbrojtjes ushtarake, inteligjencës, mbrojtjes ajrore, trafikut ajror e mbi të gjitha industrisë ushtarake. Duhet ta ndërtojmë dhe të zhvillojmë këtë industri, duhet bashkëpunuar thellësisht e praktikisht për unifikim të tregut, me theks të veçantë në tregun e energjisë duke konsideruar dhe trajtuar si siguri nacionale. Duhet të bashkëpunojmë thellësisht dhe praktikisht në unifikimin e plotë legal dhe formal të arsimit dhe shëndetësisë. Duhet adresuar përgjegjësinë që ka Kosova dhe Shqipëria për shqiptarët në Luginën e Preshevës, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe në Çamëri. Nisur nga gjendja aktuale dhe trendët e largimit masiv si në Kosovë dhe Shqipëri, duhet të koordinohemi dhe të angazhohemi që të bëjmë Kosovën, Shqipërinë vende më të mira për të jetuar, e për ata që janë larguar të angazhohemi që të kemi programe të veçanta për të ruajtur gjuhën dhe kulturën shqipe.

Të nderuar kolegë deputetë, sot ne jemi dy shtete, kemi dy qeveri, kemi dy kuvende, por kemi një rrugë, një adresë, njëdrejtimëshe, integrimin e plotë në familjen tonë natyrale, në familjen perëndimore. Kemi miqësi e partnerë të njëjtë, SHBA-në dhe BE-në, kemi flamurin shqiptar në NATO, por shpejt duhet ta kemi dhe flamurin e Kosovës përkrah. Në sistemin politik që operojmë me të drejtë parlamentet janë tempuj të demokracisë, zhvillimin dhe mbrojtjen, ndaj dhe parlamentet tona janë pushtet që duhet të respektohet dhe të zbatohet. Ne si të zgjedhur nga qytetarët e vendeve tona, me ushtrim të pushtetit legjislativ e kryejmë një detyrë thelbësore e kryesore: krijimin e ligjeve, harmonizimin e tyre me standardet më të larta evropiane. Mbrojtja e zhvillimit të demokracisë, kontrolli i institucioneve tjera kushtetuese, si dhe përcaktimi i orientimit politik të vendeve tona konsideroj se janë vetë fondamenti i angazhimit tonë si përfaqësues të zgjedhur të popullit tonë.

Të nderuar deputetë, jeta parlamentare në Republikën e Kosovës bart dhe historinë e vet. Ka një trashëgimi të viteve '90-ta, ku Parlamenti i Kosovës në atë kohë, i cili ishte nën sulm nga Serbia, kishte përkrahjen e Parlamentit të Shqipërisë, ku politika dhe organizimi kishte përkrahjen e Shqipërisë, ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte përkrahjen e Shqipërisë, sot ajo nuk është në ditët më të mira të saj.

Të dashur vëllezër dhe motra, më lejoni që në gjuhën më të bukur në botë, në gjuhën shqipe, t'i lutemi Zotit që t'i bashkojë shqiptarët kudo që janë. Të bekojë historinë e shqiptarëve, gjuhën dhe kulturën e shqiptarëve, miqtë e shqiptarëve në rrugën tonë integruese.

Bekuar qofshin shqiptarët, bekuar qofshin ata që i bashkojnë shqiptarët!
Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës dhe shqiptarët kudo që janë! Faleminderit!

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: Një përshëndetje të veçantë do t'ia bëjmë deputetit Shaip Kamberi.

Të kërkoj ndjesë, Shaip, por unë të kërkoja të mysafirët atje lart dhe ti qenke ulur këtu në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Faleminderit shumë që keni ardhur!

Tash ia jap fjalën Gazmend Bardhit, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

GAZMEND BARDHI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës!

E nderuar zonja kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe Kuvendit të Shqipërisë,

Të dashur qytetarë të Kosovës dhe të Shqipërisë,

Pa diskutim që nuk e kam ndërmend ta prish traditën e shqiptarit, për ta kthyer këtë mbledhje të sotme të dy kuvendeve tona në një transformim të luftës sonë të brendshme në Shqipëri. Mund të flisja shumë për çfarë ka ndodhur në këto 10 vjet në Shqipëri. Mund të flisja shumë edhe se si janë marrëdhëniet mes dy vëllezërve, Kosovës dhe Shqipërisë, gjatë këtyre viteve të fundit, por nuk e kam ndërmend ta kthej këtë diskutim të sotshëm në një fushatë elektorale, apo të përdor Kosovën për fushatë elektorale.

Nuk e kemi bërë kurrë dhe nuk do ta bëjmë kurrë. Por, një mesazh referuar nga fjala që kryeministri, që në fakt e lanë nervat dhe braktisi sallën, foli sot përpara deputetëve, ne shqiptarët kemi një traditë, vëllait nuk ia themi kurrë këshillën në publik, nuk ia themi kurrë këshillën në lagje. Vëllait këshillën ia themi në shtëpi, me zë të ulët që të mos na dëgjojnë të tjerët.

E kundërta e kësaj, një këshillë edhe kur është e drejtë, e thënë në publik, e lëndon vëllain. E dobëson pozitën e tij në arenën ndërkombëtare dhe sigurisht është një thikë pas shpine për vëllain tonë, Kosovën tonë të dashur.

Të nderuar kolegë,

Me krenari dhe një ndjenjë të përbashkët përgjegjësie diskutojmë sot këtu mes vëllezërve dhe motrave të bashkuar nga historia, kultura dhe një ëndërr që shkon përtej kufijve formalë mes dy vendeve tona.

Sot mblidhemi këtu si një moment për të reflektuar mbi atë që kemi arritur dhe për të përcaktuar drejtimin e përbashkët për atë që na mbetet ende për të bërë. Kosova dhe Shqipëria duhet të jenë simbol i një vizioni, ku ekonomitë tona jo vetëm që ndërthurën, por lulëzojnë së bashku.

Një vizioni, ku të rinjtë shqiptarë të Kosovës dhe Shqipërisë, plot talent dhe ambicie gjejnë mundësi brenda atdheut të tyre, këndeje dhe andej kufijve formalë, dhe jo duke kërkuar të ardhmen larg tij.

Është detyrë jona e përbashkët të shtrojmë rrugët që do të lidhin vendet tona në tregti, arsim dhe inovacion. Por, për të arritur këtë, duhet të qëndrojmë të gjithë bashkë përballë sfidave. Kohët e fundit, politikat e ndjekura nga ne në Shqipëri nuk kanë pasqyruar gjithmonë frymën e vëllazërisë që i bashkon qytetarët tanë.

Rruga e Kosovës drejt vetëvendosjes është shënuar nga guximi, por gjithashtu është përballur me presione të padrejta dhe sanksione që synojnë të heshtin zërin e saj të drejtë në dialogun me Serbinë.

Unë dua të jem i qartë, në emër të Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe grupit tonë parlamentar, se qëndrojmë fuqimisht kundër masave dhe sanksioneve ndaj Kosovës. Është e papranueshme të ndëshkohet Kosova për qëndrimet e saj parimore. Ato penalizojnë Kosovën për kërkesat e saj legjitime për të qenë një shtet i barabartë dhe i pavarur në tryezën e bisedimeve. Veprime të tilla rrezikojnë të shndërrojnë dialogun në një akt presioni, dhe asnjë paqe e qëndrueshme në botë nuk mund të ndërtohet mbi themele të pabarazisë dhe shtrëngimit. Ajo duhet të ndërtohet mbi respektin e ndërsjellë dhe barazinë në tryezën e negociatave.

Është detyrë jona, e Shqipërisë, të amplifikojë zërin e Kosovës në arenën ndërkombëtare për t'ia kujtuar botës se pavarësia e Kosovës nuk është e negociueshme. Dhe, për të mbështetur përpjekjet e Kosovës për të ndërtuar një të ardhme të përcaktuar nga paqja, siguria dhe mirëqenia e qytetarëve të saj.

Thënë kjo, dua të theksoj gjithashtu, se për Shqipërinë, Kosova është dhe duhet të mbetet me çdo çmim ylli polar i politikës sonë të jashtme. Qëllimet e saj nuk duhet të vihen kurrë nën dyshim nga Republika e Shqipërisë, dhe e vetmja ndërhyrje në politikën e brendshme që Shqipëria ka të drejtë të bëjë në Kosovës, është shtrirja e dorës për ndihmë, për mbështetje, veçanërisht mbështetje në rrugën evropiane, duke bërë detyrën tonë në garantimin e njohjeve të reja për Kosovën, duke nisur nga 5 vendete e Bashkimit Evropian.

Duhet guxim për të pranuar gabimet e së kaluarës, por vetëm përmes kësaj përpjekjeje mund të forcojmë partneritetin mes dy vendeve vëllazër.

Le të jetë ky moment një pikë kthese, ku Shqipëria jo vetëm premt, por ofron mbështetje të palëkundur për aspiratën dhe sfidat e Kosovës.

Prandaj, të nderuar kryetarë të kuvendeve të Shqipërisë dhe Kosovës, propozimi ynë është që kjo të jetë mbledhja e fundit formale ndërmjet dy kuvendeve tona me fjalime ceremoniale, por të kalojmë në veprime konkrete. Të ndërmarrim angazhime solemne për krijimin e një komisioni të përbashkët gjithëpërfshirës parlamentar që do të ketë për qëllim të ndërtojë një agjendë të qartë pune, duke filluar me monitorimin e marrëveshjeve të përbashkëta mes Shqipërisë dhe Kosovës, që për hir të së vërtetës në të shumtat e rasteve ka mbetur vetëm në letër, ndërkohë që ne duhet të bëjmë gjithçka mundemi për t'i shndërruar në një realitet të përbashkët për qytetarët tanë në të dy anët e kufijve formalë.

Më lejoni të sjell në vëmendje se Rruga e kombit ka bashkuar shqiptarët më shumë se 1 mijë fjalime që ne mund të mbajmë në formate të tilla të marra së bashku. Prandaj, ne kemi nevojë për projekte të tilla të përbashkëta që sjellin zhvillim për qytetarët e dy vendeve tona.

Ne duhet të veprojmë si dy kokat e shqiponjës në flamurin tonë kombëtar, duke u ngritur së bashku drejt lartësive të reja. Ky moment duhet të shërbejë si një betim për të punuar më fort se kurrë, për të forcuar lidhjet tona jo vetëm me fjalë, por me vepra.

Prandaj, ne propozojmë që delegacionet tona parlamentare në të gjitha organizmat e huaja të koordinojnë paraprakisht qëndrimet e tyre, në mënyrë që Shqipëria dhe Kosova të flasin me një gjuhë dhe mesazh të unifikuar në arenën ndërkombëtare.

Qëndrimet e të dyja shteteve tona duhet të reflektojnë atë që në të vërtetë jemi, një komb, një gjuhë, një qëndrim. Gjithashtu, duhet të kujtojmë se bashkimi ynë dërgon një mesazh të fuqishëm në botë se shqiptarët, qoftë në Tiranë apo në Prishtinë, do të jenë gjithmonë bashkë.

Prandaj, në vijim edhe të thirrjes së presidentes së Republikës së Kosovës, zonjës Vjosa Osmani, më 18 dhjetor 2020 në Kuvendin e Shqipërisë, apeloj Shqipërinë, në rastin konkret mazhorancën, që të jetë shteti i dytë pas Kosovës që dënon gjenocidin serb pa vonesa dhe pa pikëpyetje.

Kuvendi i Shqipërisë duhet të miratojë menjëherë rezolutën për dënimin e krimeve kundër njerëzimit që Serbia e ka kryer në Kosovë, si dhe të kërkojmë që të zbardhet sa më parë fati i të zhdukurve. Teksa ky vit po përfundon, le të hyjmë në të ardhmen me një besim të ri në unitetin tonë dhe në një angazhim të palëkundur për të ndërtuar një të ardhme që meriton sakrificat që kanë bërë brezat para nesh. Bashkë, dhe vetëm bashkë mund të sigurojmë që Shqipëria dhe Kosova të vazhdojnë të qëndrojnë si garant të stabilitetit dhe shpresë në Ballkan dhe përtej.

Kosova dhe Shqipëria duhet të përqendrohen te fushat që kanë më shumë rëndësi për qytetarët tanë. Ne mund të ndërtojmë tregje të integruara dhe projekte të përbashkëta infrastrukturore për të nxitur tregtinë dhe rritur ekonominë e dy vendeve tona.

Mund të zhvillojmë programe arsimore dhe kulturore për të forcuar ndjenjën e përbashkët të identitetit dhe mundësisë për të rinjtë tanë. Mund të forcojmë bashkëpunimin tonë në mbrojtje dhe siguri, duke garantuar sigurinë e gjithë qytetarëve shqiptarë.

Prandaj, mbi të gjitha, ne duhet të qëndrojmë të bashkuar në përpjekjet e Kosovës për njohje të plotë ndërkombëtare, dhe vendin e saj të merituar në Aleancën Euroatlantike, në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Kjo nuk është thjesht betejë e Kosovës, kjo është edhe beteja jonë, është betejë e përbashkët e Kuvendit të Shqipërisë dhe e Kuvendit të Kosovës.

Vëllezër dhe motra,

Për ne, Kosova është Shqipëri po aq sa Shqipëria është Kosovë. Bashkërisht duhet të jemi edhe më fuqishëm në krah të çdo shqiptari kudo ku ata janë në rajon.

Në përfundim, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, u urojmë suksese të gjitha forcave politike në zgjedhjet e 9 shkurtit të vitit të ardhshëm. Urojmë një proces të qetë, të drejtë dhe të barabartë. Dhe, urojmë që vullneti i popullit të Kosovës për një të ardhme të begatë të fitojë.

Faleminderit!

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Ftoj për fjalën e tij zotin Enver Hoxhaj, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, dhe nënkryetar i Kuvendit të Kosovës.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zonja kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, zonja Spiropali!

Zoti kryetar i Kuvendit të Kosovës, zoti Konjufca,

Kryeministër Rama,

Kryeministër Kurti,

Kabinete të të dyja qeverive, të Kosovës dhe të Shqipërisë,

Shumë të dashur kolegë,

Meqë jam prej folësve të parafundit apo i fundit, nuk dua të zgjas, por kam ndërmend që t'i them disa gjëra që mendoj që ia vlen.

Nuk ka mënyrë më të mirë për ta përmbyllur mandatin e këtij Kuvendit të Kosovës, të kësaj legjislature sesa kjo seancë e përbashkët e të dyja kuvendeve tona. Kjo seancë e përbashkët e kuvendeve tona shpresoj që është edhe ogur i mirë, paralajmërim i mirë, shenjë e mirë që në qeverinë e ardhshme të Kosovës bashkëpunimi me Shqipërinë të jetë prioritet i parë dhe jo prioritet i fundit, sikurse ka qenë viteve të fundit.

Shqipëria për ne është binjaku identitar edhe historik, edhe demografik i Kosovës, dhe bashkëpunimi mes kuvendeve dhe qeverive duhet të jetë çdoherë prioritet i çdo politike në Kosovë dhe në Shqipëri.

Jam shumë i lumtur që sot shoh shumë vëllezër dhe motra apo motra dhe vëllezër nga të dyja kuvendet. Keni ardhur pakëz me vonesë, meqë ne i kemi mbyllur listat tona të kandidatëve për deputetë, i kemi dorëzuar në Komisionin Qendror Zgjedhor, përndryshe, do t'i ftoja disa nga ju, ata të cilët do ta kishin vullnetin politik, që të garonin dhe të bëheshin pjesë e këtij Kuvendi të Kosovës.

Besoj që salla është e bukur dhe popullin të cilin e përfaqësoni e ka vullnetin politik që t'ju votojë. Por, natyrisht që kur ju shoh në këtë sallë më shumë i ngjani një asambleje nacionale kombëtare, një pamje të cilën sigurisht do të mund ta ketë pasur edhe Sami Frashëri para 150 vjetësh.

Kjo seancë e përbashkët e të dyja kuvendeve tona është një ngjarje me rëndësi, sepse për Kosovën, Shqipëria është jo vetëm një partner i natyrshëm strategjik, por të dyja republikat tona, duke i takuar një kombi, nuk janë asgjë tjetër, veçse zgjerim, zgjatje e natyrshme e njëra-tjetrës.

Kjo edhe ka qenë arsyeja pse para 10 ditës, jo në dhjetor sikurse sot, por në janar, jo në Prishtinë dhe në Tiranë, por në Prizren, në kryeqytetin historik të shqiptarëve, nën udhëheqje të kryeministrit Thaçi dhe kryeministrit Rama, është mbajtur mbledhja e parë e të dyja qeverive.

Për më shumë, nuk ka qenë një mbledhje e thjeshtë e të dyja qeverive, por ka qenë shpallje e një partneriteti strategjik, i cili vazhdon edhe sot e kësaj dite me shumë mbledhje që kanë mbajtur qeveritë e ndryshme.

Natyrisht që një partneritet i tillë shkon thellë në histori, meqë historikisht Shqipëria ka pasur një rol dhe ka dhënë një mbështetje të shumanshme ndaj Kosovës, sepse pa Shqipërinë, s'do të kishte as liri, as pavarësi.

Në historinë pothuajse më të gjatë se sa një shekull të shtetit shqiptar, rrethanat e brendshme kanë ndryshuar shpesh, edhe rendet ndërkombëtare me të cilat ka mbijetuar shteti shqiptar kanë ndryshuar shpesh, por mbështetja e Shqipërisë ndaj lëvizjeve të ndryshme politike dhe kulturore që ka luftuar për lirinë e Kosovës ka qenë e përhershme, ka qenë konstante. Nga Hasan Prishtina e Azem Bejta deri tek Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Adem Jashari.

Nga rezistenca civile, deri te lufta e armatosur. Nga Universiteti i Prishtinës, deri te gjuha standarde shqipe që flasim ne sot në këtë Kuvend të Kosovës.

Pa Shqipërinë jo vetëm që nuk do të fitonim luftën tonë për çlirim, por do të mund të ballafaqoheshim me asimilim nga politikat e egra të regjimeve të ndryshme serbe. Për më shumë, Shqipëria ka qenë mburoja jonë e sigurisë fizike kur ne si popull në vitin 1999 u përballëm edhe me gjenocidin.

Ky rikthim imi i shkurtër në histori e ka vetëm një qëllim, për të thënë nga foltorja e Kuvendit të Kosovës: faleminderit, Shqipëri! Edhe për të thënë më qartë, se Shqipëria nuk ka pasur vetëm një rol solidar, sikurse ndonjëherë dëgjohet, por ka pasur një rol vendimtar dhe mbështetës për Kosovën.

Ne i jemi shumë mirënjohës Shqipërisë për rolin që ka pasur gjatë kohës së pavarësimit të Kosovës. Për lobimin që ka bërë njohje ndërkombëtare të saj dhe për anëtarësimet e shumta në organizatat ndërkombëtare.

Duke qenë si dikush, i cili ka qenë pjesë e procesit politik të shtetformimit dhe të shtetndërtimit të Kosovës, e di që kudo që nuk ka pasur mundësi të flasë Kosova, nuk ka pasur të hyjë në ndonjë takim ndërkombëtar Kosova, apo nuk ka pasur mundësi që të udhëtojë në ndonjë vend të largët, ka qenë zëri i Shqipërisë dhe ka qenë prania e Shqipërisë si përfaqësim i Kosovës.

I jemi shumë mirënjohës kryeministrit Rama edhe për atë se çfarë tha sot në Kuvendin e Kosovës, por edhe për atë se çfarë thotë dhe bën Qeveria e shtetit shqiptar dhe Qeveria e tij në mbështetjen zyrtare politike dhe publike të kauzës së drejtë të presidentit Thaçi, të kryetarit Veseli, të kryetarit Krasniqi dhe deputetit Selimi dhe të të gjithë eprorëve të tjerë të UÇK-së, të cilët padrejtësisht po mbahen në Hagë.

Jemi të sigurt që ata do të kthehen edhe fitimtarë, edhe faqebardhë.

Për ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës është e papranueshme përpjekja për ta rishkruar historinë, duke e zëvendësuar viktimën me agresorin. Krahas përpjekjes për

rishkrimin e historisë, kemi një rikthim të gjeopolitikës së vjetër në Ballkan dhe në Evropë. Është rikthyer edhe ambicia serbe për hegjemoni në Ballkan.

Kjo u shpërfaq vitin e kaluar me agresionin në Banjaskë për ta aneksuar veriun e Kosovës, dhe para tri javësh me sulmin terrorist në Varagë në kanalin e Ibër Lipencit që e furnizon Kosovën me ujë.

Duke qenë në proces të normalizimit të raporteve me Serbinë, Serbia vitin e kaluar kishte për qëllim të marrë një pjesë të territorit të Kosovës, këtë vit ta lërë Kosovën pa ujë, pa drita dhe pa energji. Prandaj, Serbia ka hequr dorë nga zgjidhja politike e mosmarrëveshjes së saj me Kosovën, duke e zëvendësuar apo duke bërë përpjekje për ta zëvendësuar atë me zgjidhjen ushtarake.

Ka zëvendësuar dialogun si mjet diplomatik, me përdorimin e dhunës politike për të përmbushur qëllimet e saj.

Për ne si deputetë të të dyja kuvendeve, por edhe të dyja qeverive tona, është me rëndësi që të definohet në situatën e re se çka nënkupton bashkëpunimi ndërshtetëror Kosovë-Shqipëri sa i takon mbrojtjes, sa i takon sigurisë. Se çfarë veprimesh të përbashkëta diplomatike duhet të ndërmerren.

Takime të mira të bazuara në paqartësi strategjike, me tone romantike, pa substancë, nuk besoj që na ndihmojnë shumë në këtë kohë.

Serbia është agresori edhe ajo qëndron në mënyrë të drejtpërdrejtë pas të dyja akteve të agresionit, por ajo nuk po ndëshkohet. Është duke u ndëshkuar Kosova, e cila është nën sanksione. Pra, e cila është mjerisht edhe pa kredibilitet ndërkombëtar.

Shpresojmë dhe kërkojmë nga Shqipëria që ta mbështesë Kosovën që të dalë nga ky rreth vicioz i izolimit dhe i sanksionimit.

E ftoj Qeverinë edhe të Shqipërisë, edhe të Kosovës, po edhe të dyja kuvendet tona që ta ndjekin një qëllim më të lartë që duhet ta ketë Kosova, dhe ai duhet të jetë anëtarësimi i Kosovës në NATO.

Kur jemi mbledhur si deputetë, e dimë që janë disa ide, disa ideale, disa rrethana, disa faktorë që japin idenë qendrore të kombit shqiptar. Duke qenë një kombi përbashkët dhe i tillë do të jemi, ne sot jemi në tri shoqëri të ndara në Ballkan: një shoqëri në Shqipëri, një shoqëri në Kosovë, një shoqëri e tretë në Maqedoni të Veriut. Prandaj, mendoj që ndër prioritetet më të larta të një bashkëpunimi të ardhshëm duhet të jetë krijimi i një shoqërie

të përbashkët shqiptare në Ballkan me një treg të përbashkët. Ju faleminderit për vëmendje! Rroftë Shqipëria! Rroftë Kosova! Rroftë kombi shqiptar!

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: Tash, më lejoni ta ftoj Niko Peleshin, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

NIKO PELESHI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Konjufca, E nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonja Spiropali,

I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Albin Kurti,

I nderuar kryeministër i Republikës së Shqipërisë, zoti Edi Rama,

Të dashur kolegë deputetë,

Miq,

Motra dhe vëllezër,

Kjo seancë e përbashkët e dy parlamenteve tona vjen pas një tradite shumë pozitive të krijuar përmes organizimi të mbledhjeve të përbashkëta qeveritare dhe kuvendeve tona.

Ky takim i dytë nuk është vetëm një simbolikë e bashkëpunimit të shkëlqyer ndërmjet institucioneve tona, por edhe një shprehje e qartë e unitetit tonë kombëtar të pandarë.

Marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës janë një model bashkëpunimi i bazuar në vëllazëri. Në vlera të njëjta dhe në synime të qarta për të ardhmen. Me të mirat dhe dobësitë tona të cilat i kemi, gjithashtu, të përbashkëta.

Jemi njëlloj edhe në temperamentin politik, siç u pa sot këtu, por mbetemi vëllezër, vëllezër të një shtëpie të përbashkët.

Kuvendi ynë, ashtu si çdo qelizë tjetër e Shqipërisë, ka qenë gjithmonë mbështetësi i palëkundur i aspiratave të Kosovës për liri, pavarësi dhe integrim ndërkombëtar.

Kosova dhe Shqipëria ndjekin një rrugë të përbashkët euroatlantike. Ne kemi të njëjtën adresë të destinacionit tonë historik, Bashkimin Evropian. Shqipëria mezi pret mbërritjen e Kosovës në Aleancën më të fuqishme politike dhe ushtarake (NATO), aty ku Shqipëria ka zënë vend si aleat prej 15 vjetësh në hapësirë. Ne nuk do të reshtim së kërkuari vëmendje dhe siguri për Kosovën që mbetet prioriteti ynë kryesor në çdo ministerial në NATO, në çdo samit të liderëve, ne e fillojmë dhe e mbyllim me Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor.

Nuk ka moment më të mirë për të ripohuar përkushtimin tonë të përbashkët për të përshpejtuar procesin e integritit evropian dhe për të forcuar demokracinë dhe prosperitetin në rajonin tonë.

Bashkëpunimi parlamentar midis dy vendeve tona ka shënuar hapa të rëndësishëm, veçanërisht pas nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit në vitin 2022. Përmes këtij dokumenti, ne kemi krijuar një kornizë të përbashkët për harmonizimin e legjislacionit, forcimin e diplomacisë parlamentare dhe rritjen e transparencës ndaj qytetarëve tanë.

Ky memorandum është prova më e mirë e angazhimit tonë për t'i dhënë formë konkrete aspiratave tona të përbashkëta. 7 mbledhjet ndërqeveritare dhe 58 marrëveshje të nënshkruara janë dëshmi e qartë e frymës së bashkëpunimit që na udhëheq. Nga nismat për lëvizjen e lirë dhe integrimin ekonomik, deri tek iniciativat për bashkëpunim në arsim dhe kulturë, ne po ndërtojmë një model të përbashkët zhvillimi që u shërben të gjithë qytetarëve tanë.

Megjithatë, bashkëpunimi nuk duhet të kufizohet vetëm në marrëveshje. Ai duhet të reflektohet në çdo nivel të jetës publike dhe politike. Sot më shumë se kurrë kemi nevojë për veprime konkrete për të adresuar sfida të përbashkëta dhe për të shfrytëzuar çdo mundësi në të mirë të qytetarëve tanë.

Këtu diplomacia parlamentare ka një rol të veçantë. Kuvendi i Shqipërisë dhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste mbeten të angazhuar të mbështesin Kosovën në forcimin e pozitës së saj ndërkombëtare, në shtimin e njohjeve dhe në procesin e integritit në organizatat ndërkombëtare.

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës dhe avancimi drejt Bashkimit Evropian janë prioritetet të përbashkëta që kërkojnë angazhimin e të gjithëve.

Nën emocionet që krijon simbolika e këtij takimi historik, më lejoni të bëj edhe një reflektim që shkon përtej ngjyrave politike dhe kufijve të shteteve tona. Shpesh retorika politike e përditshme na rrëmben dhe na zhyt në qëllimet politike afatshkurtra, duke harruar interesin afatgjatë të shqiptarëve në të dyja anët e kufirit. Ndonjëherë harrojmë se ajo që na bashkon është shumë më e madhe dhe më e rëndësishme se çdo ndasi.

Ne nuk jemi ne dhe ju, ne jemi ne, shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosovës. Historia na ka ndarë për ca kohë, por sot janë ditët më të mira të shqiptarëve. Jo pa kërcënime dhe rreziqe, por siguria dhe paqja, sovraniteti dhe integriteti i Kosovës janë të pakthyeshëm, ashtu sikundër Shqipëria sot është në segmentin e fundit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian me një datë, me një kalendar, me një plan pune të dakorduar me institucionet e Bashkimit Evropian, dhe kjo do të jetë më afër se sa mendohej, viti 2030.

Ne duhet t'i shërbejmë këtij momenti për llogaritë e së ardhmes së bashkimit kombëtar në flamurin e Bashkimit Evropian dhe flamurin kuqezi. Në fund të fundit, ky do të jetë metri me të cilin do të na matë historia që nuk ka filluar me ne e nuk do të përfundojë me ne.

Le të punojmë së bashku për një të ardhme, ku shqiptarët në të dyja anët e kufirit të jetojnë në paqe, në zhvillim dhe me dinjitet. Ne kemi përgjegjësinë, por edhe fuqinë për ta bërë këtë ëndërr realitet.

Në mbyllje, dua të uroj të gjithë shqiptarët në Kosovë, në Shqipëri dhe kudo në botë në diasporë, gëzuar festat e fundvitit! Le ta kthejmë së bashku vitin 2025 në një vit arritjesh për shqiptarinë. Rroftë Kosova! Rroftë Shqipëria!

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Ftoj për fjalën e saj zonjën Mimoza Kusari-Lila, kryetare e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Kuvendi i Kosovës.

MIMOZA KUSARI-LILA: Të nderuar kryetarë të Kuvendeve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, zoti Glauk Konjufca dhe zonja Elisa Spiropali, Të nderuar kryeministra të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, zoti Albin Kurti, zoti Edi Rama, me kabinetet tuaja qeveritare, Të respektuar ambasadorë Malaj dhe Durmishi, Të nderuar kolegë deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, Të dashur bashkëkombas në Kosovë, Shqipëri dhe kudo që jeni, në veçanti ju në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, Shumë i nderuar deputet Shqip Kamberi, jeni të ulur aty ku e keni vendin, në mesin e Kuvendit gjithëshqiptar, Mirë se po takohemi në Prishtinë në një takim sa festiv, po aq edhe reflektiv në kohën kur po mbyllim vitin dhe legjislaturën e tetë, ndërsa po përgatisim dhe prezantojmë programet për vitin e ri dhe mandatin e ardhshëm.

Në këtë sallë plenare, ku fjala e secilit prej nesh ndërtohet mbi themelet e përbashkëta të gjuhës, kulturës dhe ëndrrave të njëjta, nuk shoh kufij, nuk shoh pengesa. Shoh një hapësirë të madhe të mundësive dhe është momenti që këto mundësi t'i kapim me guxim dhe vizion.

Jemi me fat dhe të privilegjuar secili prej nesh të kemi mundësinë e këtij takimi dy herë brenda së njëjtës legjislature. Për gjeneratat para nesh ishte një çmim, por gjithashtu çmim që nënkuptonte ose që shkonte deri në flijim. Sot për ne është jo vetëm realitet, por edhe detyrë për ata që nuk janë më dhe ata që do të vijnë pas nesh që ky komunikim të

avancojë në integrim të përbashkët dhe projekte të cilat do të shënojnë jo vetëm zonën mbarëshqiptare, por Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.

Përderisa është një mal në mes të fjalëve të thëna dhe veprave të kryera, si dy shtete, por si një popull, ne duhet të kemi shikimin, mendjen dhe veprimin tek projektet që na përbashkojnë, integrojnë dhe mbi të gjitha, shtojmë arsyet për gjithë potencialin njerëzor shqiptar që kontribuon gjithandej nëpër botë, të shoh këtë hapësirë vend të mundësive për t'u kthyer në mëmëdhe.

Talentet shqiptare që kanë depërtuar dhe zbuluar veten në nivelin botëror, sikurse Mira Murati që u përmend më herët, duke e ridizajnuar mënyrën se si po funksionon teknologjia dhe si ajo ndikon në jetën e secilit banor të globit.

Të dashur bashkatdhetarë,

Të nderuar kolegë,

Në kohët më të vështira për Kosovën nën represion, çdo fjalë e thënë nga Tirana, aktivitet apo shenjë, dërgonte shkëndija shprese në Kosovë. Ndriçonte errësirën e një populli nën regjim brutal, muzgun e të cilit ende nuk e ka ndritur dielli i demokracisë të fqinji ynë verior.

Atëbotë, për Kosovën, Shqipëria nuk ishte vetëm vendlindja e dytë, shtëpia dyert e së cilës ishin mbyllur për pjesën tjetër shqiptare, por adresën e së cilës e mbanim me vete, pa dashur të ëndërrojmë ose të mendojmë se kemi shtëpi tjetër.

Shumë vjet pas, kemi fatin të punojmë për jetën në një shtëpi më të madhe me rregulla e ligje, të cilat duhet t'i përafrojmë, duke i vënë në pah përparësitë dhe vlerat që bashkë ne do t'i sjellim kur të jemi pjesë e barabartë e familjes evropiane.

Kjo barazi sot nuk është tërësisht e aplikueshme për shtesat e Republikës së Kosovës, të cilët ende mbeten besimtarët më të devotshëm në procesin e integritetit të shtetit të tyre në Bashkimin Evropian.

93% e kosovarëve e kanë besimin për këtë bashkësi përderisa ajo mban vlerësimin më kritik ndaj tyre për shkak të vendimeve sovraane në momentet kritike të sigurisë, për shkak të ushtrimit të sovranitetit dhe ruajtjes së integritetit në secilin cep të shtetit tonë.

Më vëmendje të madhe e dëgjuam fjalimin e kryeministrit Rama. Po kryeministër, Gjykata Speciale është e padrejtë dhe në vitin 2015, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje jo vetëm që e kundërshtoi, por gjithashtu e dërgoi në Gjykatën

Kushtetuese, se nuk mund të ketë një gjykatë, e cila në mënyrë të njëanshme, njëetnike, gjykon lufton Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Atëbotë, njëjtë ishte rekomandim ndërkombëtar se duhet të bëhet për të ardhmen e Kosovës. Me të njëjtin dyshim dhe me të njëjtin vlerësim kritik kemi shikuar aktualisht propozimet për zgjidhje të tjera njëetnike në territorin e Republikës së Kosovës për të parandaluar çfarëdo të keqe që pas 10 vjetëve mund të minojë dhe të cenojë sovranitetin, integritetin dhe funksionimin e shtetit tonë.

Prandaj, duke e marrë parasysh gjithë mbështetjen dhe përkrahjen që kemi nga Republika e Shqipërisë, të adresohet problemi aty ku e ka burimin, në Këshillin e Evropës, në NATO, në Këshillin e Sigurimit, ku Shqipëria është anëtare e barabartë, se po zhvillohet një gjykatë që padrejtësisht në baza etnike gjykon çlirimtarët dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës prej vitit 2021 ka qenë e angazhuar me përkushtim të madh në mbrojtjen dhe të gjithë mekanizmat që i duhen, përfshirë edhe mjetet financiare për ata që kanë nevojë për avokatë dhe mbrojtje të mirëfilltë në Hagë.

Megjithatë, ne përkundër se jemi në dy stadi të ndryshme të procesit të integritetit, i gëzohemi pafundësisht progresit të Shqipërisë, e cila ka hapur kapitujt për negociim, dhe ky fakt tashmë na e zgjeron rrugën e bashkëpunimit dhe thëllon komunikimin ndër-institucional prej atij të nivelit të shërbyesve civilë dhe Administratës, e deri te drejtuesit e shtetit.

Duke qenë dëshmitarë të standardeve të qarta teknikisht, por të rënduara politikisht nga Bashkimi Evropian, bashkëpunimi dhe sukcesi ynë si dy shtete në ndërveprim dhe realizimin e projekteve, duhet të jetë prioritet në agjendat shtetërore dhe politike prej këtij Kuvendi të përbashkët e deri tek Ekzekutivi. Ndërsa, duke e marrë parasysh që bashkë do të jemi në procese zgjedhore në vitin e ri edhe Shqipëria edhe Kosova, të dyja vendet në të gjitha nivelet dhe secilën parti që garon duhet t'i kenë të qarta planet e tyre për bashkëpunimin kombëtar.

Më lejoni të prezantoj disa nga të arriturat dhe synimet që mendoj janë shumë të rëndësishme t'i përcjellim tutje nga ky Kuvend për agjendën e legjislaturës së radhës.

Bashkëpunimi ynë në infrastrukturë deri më tani është kurorëzuar me rrugën e kombit dhe me rrugët e projektet që lidhin vendbanimet kufitare. Ndërsa, si kurorë e këtij bashkëpunimi dhe ndërlidhje, duhet të konkretizohet sa më parë me vendim dhe hapa

konkret e të matshëm kohor projekti i hekurudhës Prishtinë-Durrës përmes rrugës që lidh Gjakovën me Shkodrën.

Ky projekt do të përshpejtojë ngritjen e trungut në nivelin kulturor, turistik, ekonomik dhe mbi të gjitha, unifikojë komunikimin i cili edhe në kohën e perdes së hekurt dikur, vazhdonte e ushqej me atdhetarinë, patriotizmin dhe frymëzimin kombëtar.

Të mendosh se në tren prej Gjakovës mund ta arrish Shkodrën për një orë e gjysmë, e Ulqinin për dy orë, është jo vetëm një ëndërr e bukur, por një realitet që thërret të ndodhë.

Në energji është realizuar projekti për ndërlidhjen e sistemeve energjetike, si ndërtimi i linjës së energjisë elektrike që e lidh Kosovën me Shqipëri. Prioritet i kamotshëm i pasuruar me bursën e energjisë elektrike ALPEX, projekte këto që duhet të plotësohen me nismën për impiantin e përbashkët energjetik kombëtar.

Përvoja e viteve të fundit, sigurinë energjetike e ngriti në nivelin e sigurisë kombëtare, andaj puna jonë e përbashkët duhet të na mbajë fokusin në këtë projekt. Ndërvarësia e bashkëpunimit në sektorin e sigurisë, prej sigurisë rajonale e deri tek anëtarësimi i plotë i Kosovës në NATO, është vetëm jo aspiratë, është domosdoshmëri e garancisë së paqes në rajon dhe më gjerë.

E bindur se do të jetojmë shpejt në ditën kur do të kemi dy liderë apo lidere shtetërore shqiptare në Këshillin e Ministrave të NATO-s. Në ndërkohë nismat konkrete në fushën e mbrojtjes janë shumë të mirëseardhura.

Nuk mund të mos e përmend në këtë fjalim që përderisa historia, e kaluara dhe e sotmja është mbushur me emra grash që inspiruan dhe mrekulluan botën me dedikimin e tyre, si: shenjtorja Nënë Tereza, talentet si Mira Murati, Dua Lipa e Rita Ora, të artat tona, Majlinda, Nora e Distria, vajzat që preken kulmin e botës Uta dhe Mrika, si shoqëri ende kemi rrugë të gjatë të nxjerrim gjithë potencialin e shkëlqyer të vajzave dhe grave kudo që ato jetojnë.

Shkurt ju ilustroj vetëm disa të dhëna që thërrasin për një angazhim të përbashkët e strategji mbarëkombëtare për barazi gjinore. Pronësia për patundshmëri për gratë përbën vetëm 19% në Shqipëri. Punësuar në sektorin publik janë 44, ndërsa 32% në sektorin privat. Po ashtu 52.9% e grave të moshës 18 me 74 vjeç kanë përjetuar një formë dhune gjatë jetës së tyre sipas vrojtimet të INSTAT-it dhe Kombeve të Bashkuara.

Situata në Kosovë qëndron afërisht e njëjtë në përqindje. Në pronësi të patundshmërive sipas një raporti të vitit të kaluar, vetëm 19% të pronave janë në pronësi të grave, duke

pasqyruar norma patriarkale që pengojnë pavarësinë financiare dhe aktivitetin sipërmarrës të grave. Ndërsa në tregun e punës janë bërë hapa konkret për fuqizimin ekonomik, gratë përbëjnë vetëm 15,7% të të punësuarve në sektorin privat dhe 39 në sektorin publik, duke reflektuar një pabarazi të theksuar gjinore në tregun e punës.

Gjithashtu, në Kosovë një shifër prej 60% e grave që kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre. Në Kosovë prej 3 vjetësh tanimë e paguajmë me pagën minimale çdo grua të papunë gjatë lehonisë, si dhe u ndajmë shtesa fëmijëve në ato llogari të nënave.

Inkurajomë institucionet e Shqipërisë të ndërmarrin njëjtë një nismë të tillë. Nga kjo foltore e Kuvendit mbarëshqiptar, dua t'u bëj thirrje të gjitha grave dhe burrave të mbajnë vath në vesh thënien "kur gratë përparojnë, e gjithë shoqëria përparon". Dhe, gjeneratat e reja kanë një fillim të mbarë të jetë. Asnjë mjet zhvillimi nuk është më efektiv dhe fisnik se fuqizimi i grave.

Të nderuar miq,

Historia nuk është thjesht ajo që ndodh, historia është ajo që ne zgjedhim ta ndërtojmë, dhe unë nuk njoh dy vende që kanë më shumë arsye për të ndërtuar bashkë të ardhmen sesa Shqipëria dhe Kosova.

Ne jemi më shumë sesa fqinjë, jemi më shumë sesa partnerë, jemi të lidhur nga një fije që nuk këputet, një fije që mban gjallë jo vetëm të kaluarën, por edhe shpresën për të ardhmen. Dhe, kështu ju ftoj të gjithëve që sot të mos jemi vetëm përfaqësues të institucioneve, por arkitektë të një epoke të re, epokës së shqiptarëve që nuk sodisin historinë që u kalon para syve, por e krijojnë vetë atë.

Ju faleminderit!

KRYETARJA ELISA SPIROPALI: Duke e falënderuar presidenten e Kosovës, duke i falënderuar dy kryeministrat, Rama dhe Kurti, anëtarët e Këshillit të Ministrave, kryetarët e grupeve parlamentare, të gjithë deputetët në këtë Kuvend të përbashkët, për këtë qëllim të përbashkët tonë, koordinimin e agjendës tonë kombëtare për realizimin e objektivave strategjike, anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian brenda kësaj dekade, integrimin euroatlantik të Kosovës dhe njohjen përfundimtare të saj si realitet i pakthyeshëm i saj gjeopolitik, mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe rritjen e kontributit të faktorit shqiptar për zhvillimin, demokratizimin, paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë, kam kënaqësinë që t'ia kalojë fjalën kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca për të lexuar deklaratën e përbashkët të cilën do ta miratojmë së bashku në këtë Kuvend, do ta quaja, historik. Faleminderit të gjithëve! Dhe, faleminderit të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë që na kanë ndjekur sot këtu.

Kryetari Konjufca do ta lexojë deklaratën për të gjithë. Faleminderit!

KRYETARI GLAUK KONJUFCA: Po e përmbyllim edhe këtë seancë të përbashkët të kuvendeve tona, këtë seancë tri orësh, shumë të rëndësishme e të nevojshme si një vazhdimësi, sepse mbledhjen e parë siç u tha e mbajtëm në Republikën e Shqipërisë, tash po e mbajmë në Kosovë dhe uroj që kjo tashmë ta ketë themeluar një traditë, urojmë edhe për mbajtjen e mbledhjes së tretë të kuvendeve tona kurdo që të jetë mundësia në të ardhmen, vitin e ardhshëm apo kurdo qoftë.

Ne kemi përgatitur një deklaratë, e cila pastaj, kjo është simbolike, por nëse mendoni që duhet ta keni kohën dhe ta shqyrtoni si grupe parlamentare, është në rregull, mund ta caktojme edhe një kohë, por nëse me të dëgjuar pajtoheni me këtë deklaratë, nuk mendoj që paraqet problem të madh. Sa i përket kësaj seance që e mbajtëm, unë konsideroj që në çdo moment historik dhe të vështirë nëpër të cilat ka kaluar kombi ynë mospajtimet kanë qenë të pranishme dhe idetë e kundërta, mendimet e ndryshme e tjerë. Mendime të ndryshme kishte edhe në Lidhjen e Prizrenit kur u mbajt ajo, studiuesit dhe historianët na i kanë sjellë ato, të gjitha kontradiktat e mundshme dhe të gjitha mospajtimet. Mospajtime kishte edhe në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, kishte edhe aso që e kundërshtonin dhe i dimë të gjitha ato, edhe pastaj në të gjitha fazat e rëndësishme nëpër të cilat kaloi kombi ynë. Por, arsyeja pse qëndrojmë këtu dhe më të fuqishëm se kurrë është vetëm një arsye. Arsyeja është se nëpër çdo sfidë dhe kontradiktë nëpër të cilën kemi kaluar, ka ngadhënjyer gjithmonë ai opsioni kryesor, e opsioni kryesor është opsioni i unitetit dhe opsioni i progresit i ecjes përpara dhe kjo është ajo që na ka sjellë këtu dhe na ka bërë fitimtarë në çdo udhëkryq nëpër të cilin kemi kaluar dhe kështu mendoj që do të jetë gjithmonë me kombin shqiptar.

Deklaratë
e mbledhjes së përbashkët të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të
Republikës së Shqipërisë

Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të mbledhur sot në Prishtinë, e miratojnë këtë deklaratë të përbashkët.

Kuvendi i Kosovës dhe i Shqipërisë, në vijim të mbledhjes së parë të 27 nëntorit të vitit 2022 në Tiranë zhvilluan sot, më 20 dhjetor 2024, në Prishtinë, mbledhjen e dytë të përbashkët. Qëllimi i mbledhjes është koordinimi i agjendës kombëtare për realizimin e objektivave tona strategjike:

Anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian brenda kësaj dekade,

Integrimin euroatlantik të Kosovës, pra anëtarësimin tonë në NATO dhe në Bashkimin Evropian dhe njohjen përfundimtare të Kosovës si realitet i pakthyesëm gjeopolitik, mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve, si dhe rritjen e kontributit të faktorit shqiptarë për zhvillim, për demokratizim, për paqe e për siguri në rajon dhe më gjerë,

Të dy kuvendet e konfirmojnë nivelin strategjik të bashkëpunimit dypalësh në tërësinë e marrëdhënieve që të dy vendet kanë dhe zhvillojnë në rajon, marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës e kanë reciprokisht rëndësinë parësoren

Sfidat e Kosovës janë edhe sfidat e Shqipërisë dhe sukseset e Kosovës janë edhe të Shqipërisë dhe anasjelltas,

Marrëveshja mes dy kuvendeve, nënshkruar në shtator të vitit 2022 ka institucionalizuar bashkëpunimin tonë dhe i ka dhënë dhe një mbështetje të re shtytëse bashkëpunimit mes qeverive dhe institucioneve tona dhe forcimit e komunikimit ndërnjerëzor dhe lidhjeve mes qytetarëve të të dyja vendeve.

Asnjëherë më parë bashkëpunimi mes dy kuvendeve tona nuk ka qenë kaq intensiv dhe kaq frytdhënës sa këto vitet e fundit. Ne do të vazhdojmë të avancojmë bashkëpunimin tonë ndërparlamentar dhe do të punojmë për shkëmbimin e përvojave dhe përafrimit e legjislacionit kombëtar të vendeve tona edhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Të dy kuvendet do të nxisin mbështetjen dhe të monitorojnë bashkëpunimin mes qeverive dhe institucioneve të Shqipërisë dhe Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara, nënshkrimin e marrëveshjeve të reja, zgjerimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat, si dhe forcimin e lidhjeve midis qytetarëve tanë.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian brenda vitit 2030 është objektiv strategjik dhe kombëtar i Shqipërisë, një qëllim ambicioz, por plotësisht i merituar në bazë të arritjeve dhe përparimit të Shqipërisë. E vlerësojmë dhe inkurajohemi që Samiti Bashkimi Evropian-Ballkani Perëndimor rikonfirmoi politikën e zgjerimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor që synojnë të jenë pjesë e BE-së, por vijojmë të jemi të brengosur pse Kosova nuk po trajtohet. Pra, aplikacioni i Kosovës për statusin e vendit kandidat nuk po trajtohet që nga 15 dhjetori 2021. Kosova është i vetmi vend në rajon që nuk e ka fituar ende këtë status. Kosova e meriton t'i jepet statusin i vendit kandidat në Bashkimin Evropian. Ajo është një nga vendet më pro euro-atlantike në rajonin tonë. Ka bërë përparim të madh në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagës, konsolidimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit, ekonomisë e tregut të lirë.

Ne besojmë se zyrtarizimi i perspektivës evropiane për Kosovën, së bashku me heqjen e masave të vendosura nga ana e BE-së, do të luajë rol vendimtar edhe në përparimin e

dialogut Kosovë-Serbi dhe në zbatimin e detyrimit të palëve në këtë dialog. Ne nxisim pesë vendet mosnjohëse të Bashkimit Evropian ta njohin shtetin më të ri demokratik të Kosovës, pra Republikën e Kosovës. Shqipëria e ka mbështetur dhe do të vijojë ta mbështesë pranimin e Kosovës në të gjitha organizatat ndërkombëtare. Në këtë kuadër, ne besojmë se Republika e Kosovës i ka plotësuar të gjitha kushtet për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe pranimi i saj si anëtarja e 47-të e Këshillit të Evropës është vetëm një çështje kohe dhe do të ndodhë shpejt.

Të dy kuvendet e mbështesin dhe kërkojnë angazhim serioz për ta çuar përpara procesin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, në bashkëpunim të ngushtë me BE-në dhe SHBA-në, për ta finalizuar një marrëveshje, por e cila duhet të jetë marrëveshje e njohjes së ndërsjellë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e dënojnë sulmin e 24 shtatorit 2023 në Banjskë, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku, duke i bërë thirrje Serbisë që ta dorëzojë në Kosovë terroristin Milan Radoičiq që qëndron pas këtij sulmi dhe të gjithë të tjerët të përfshirë, në mënyrë që ata të dalin para drejtësisë në Kosovë. Ndërkohë, i bëjmë thirrje Serbisë të tërhiqet nga qasjet e deritashme penguese për zbardhjen e këtij akti të rëndë të agresionit ndaj Kosovës me pasojë destabilizuese dhe më gjerë.

Kishim paralajmëruar se mosndëshkimi i sulmeve të Banjskës do ta nxiste përsëritjen e këtij sulmi, ndaj e dënojmë me forcë edhe sulmin terrorist të 29 nëntorit, i cili ndodhi në kanalin e Ibër-Lepencit. Vënia në shënjestër e infrastrukturës jetike të Republikës së Kosovës afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë jetën e qytetarëve të Kosovës dhe është me premisa të destabilizimit rajonal. Kjo nuk e destabilizon vetëm Kosovën, por gjithë rajonin, ndaj të dy vendet kërkojnë me forcë zbardhjen edhe të këtij sulmi të Ibër-Lepencit dhe evidentimin dhe nxjerrjen para drejtësisë të frymëzuesve dhe të kryerësve të këtij krimi të rëndë.

Të dy kuvendet u bëjnë thirrje partnerëve ndërkombëtarë që ta ndihmojnë aktivisht hetimin për zbardhjen e këtyre sulmeve dhe të bëjnë presion mbi Serbinë për të hequr dorë nga qasja e saj penguese. Të dy kuvendet e konfirmojnë se bashkëpunimi me partnerët dhe aleatët tanë me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës është i një rëndësie strategjike për arritjen e objektivave madhore kombëtare dhe atyre të integritetit. Si një anëtare aktive e NATO-s, Shqipëria do të vazhdojë ta mbështesë rritjen dhe forcimin e marrëdhënieve të Kosovës me Aleancën, dhe avancimin e aspiratës së Kosovës për anëtarësim në NATO. Kosova dhe Shqipëria e vlerësojnë dhe e nxisin rolin stabilizues të shqiptarëve kudo që ndodhen në vendet e rajonit. Si qytetarë të shteteve të tyre, ata kontribuojnë në shoqëritë përkatëse për stabilizim dhe progres dhe për nxitjen e

zhvillimeve demokratike për promovimin e stabilitetit dhe kohezionit shoqëror, zhvillimit ekonomik dhe veçanërisht avancimin e proceseve integruese evropiane dhe euroatlantike.

Të dyja kuvendet do të bashkëpunojnë ngushtë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve kudo që ata jetojnë në rajon, për ta garantuar respektimin e të gjitha të drejtave të tyre në përputhje me standardet më të larta evropiane dhe ndërkombëtare.

Të dyja kuvendet do të angazhohen për avancimin e të drejtave e të gjithë qytetarëve tanë, për promovimin e një shoqërie të barabartë dhe sa më gjithëpërfshirëse. Do të vazhdojmë të mbështesim të drejtat e pakicave, si dy shtete, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, duke siguruar që të gjitha grupet etnike dhe komunitetet t'i gëzojnë të drejtat e garantuara me ligjet dhe kushtetutat e të dyja vendeve.

Parlamenti i Shqipërisë dhe ai i Kosovës do të angazhohen për t'i koordinuar politikat e jashtme të të dyja shteteve, për t'i promovuar qëndrimet e përbashkëta në të gjitha forumet ndërkombëtare dhe për ta mbështetur njëri-tjetrin në përfaqësimin e interesave të përbashkëta në arenën ndërkombëtare.

Kjo është deklarata jonë e përbashkët. Ju faleminderit për pjesëmarrje! Ju dëshiroj çdo sukses!

Kjo ishte deklarata të cilën do të ishte mirë sikur ta votonim përmes një votimi formal.

Atëherë, kush është për këtë deklaratë?

Shumë, faleminderit! E konstatoj këtë deklaratë të miratuar nga të dyja kuvendet tona.

Faleminderit! Mirupafshim në mbledhjet e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*